

Lirije Bytyqi-Beqiri

**VËSHTRËSITË E NXËNËSVE TË ARSIMIT
FILLOR NË SHKRIM-LEXIM**



Prishtinë, 2019

Lirije Bytyqi - Beqiri

VËSHIRËSITË E NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR NË
SHKRIM-LEXIM

Dhjetor, 2019

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autore:

Lirije Bytyqi - Beqiri

Për botuesin:

Nezir Çoçaj, drejtor

Ekipi hulumtues

Gani Gajraku

Lirije Bytyqi - Beqiri

Sahare Reçica - Havolli

Safete Shala

Skender Mekolli

Arjeta Hyseni

Dhurata Ahmeti

Korrektues gjuhësor:

Bekim Morina

Përgatitja teknike:

Skender Mekolli

Shtypi:

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Përmbajtja

ABSTRAKT	6
ABSTRACT	7
LISTA E TABELAVE	8
LISTA E FIGURAVE.....	10
SHKURTESAT.....	11
HYRJE.....	12
SHQYRTIMI I LITERATURËS	13
Dallimet ndërmjet nxënësve me vështirësi dhe nxënësve me nevoja të veçanta	17
Vështirësitë e nxënësve në lexim	18
Vështirësitë e nxënësve në shkrim	20
Analiza e dokumenteve zyrtare, të hartuara nga MASHT-i	22
Kurrikula Bërthamë - Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathhtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja përmes të lexuarit dhe të shkruarit.....	22
Identifikimi i vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim.....	35
Puna me nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim.....	38
Qëllimi i studimit	39
Pyetjet e studimit.....	39
Nevoja për realizimin e projektit	40
METODOLOGJIA E STUDIMIT	41
Popullacioni dhe mostra	43
Instrumentet për studim.....	45

Procedurat e mbledhjes së të dhënave.....	48
ANALIZA E TË DHËNAVE.....	51
REZULTATET E STUDIMIT	52
Vlerësimi i nxënësve	54
Rezultatet nga vlerësimi i parë.....	54
Vështirësitë e nxënësve - llojet e vështirësive	60
Njohja dhe emërtimi i shkronjave.....	61
Vështirësitë në shkrim	63
Vështirësitë në lexim.....	65
Puna me nxënësit me vështirësi	74
Puna me grupet e leximi-shkrimit.....	81
Përdorimi i materialeve didaktike për të përmirësuar shkathtësitë e shkrimit.....	83
Vlerësimi i nxënësve që kanë qenë pjesë e grupeve të leximit dhe të shkrimit.....	86
Diskutim i rezultateve	88
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	92
REFERENCAT.....	95

Falënderim

Studimi u realizua dhe u financua nga Instituti Pedagogjik i Kosovës në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit, në komunat e përfshira në projekt. Realizimin e studimit e përkrahën dhe e ndihmuan zyrtarët e Drejtorive Komunale, drejtorët e shkollave, pedagogët e shkollave, dhe koordinatorët e shkollave të përfshira në projekt, për të cilët shprehim falënderim për angazhimin dhe përkushtimin e treguar në secilën fazë të realizimit të projektit.

Falënderim edhe për hartuesit e instrumenteve vlerësuese, Peka Räsänen dhe Gazmend Tahiraj, për përkrahjen e vazhdueshme, si dhe për kolegët e bashkëpunëtorët tanë, Gani Gajraku, Arjeta Dërguti dhe Dhurata Ahmeti.

Falënderim të veçantë edhe për hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës, Sahare Reçica-Havolli, Safete Shala, Skender Mekolli, për angazhimin, përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në realizimin e këtij projekti hulumtues.

Mbi të gjitha, falënderim të veçantë për mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit, që morën pjesë në secilën fazë të studimit, pa bashkëpunimin dhe kontributin e të cilëve ky studim nuk do të ishte i mundshëm.

ABSTRAKT

Leximi dhe shkrimi janë shkathtësi, të cilat zhvillohen që nga klasa e parë në arsimin fillor. Vitet e fundit është diskutuar mjaft shumë për problemet serioze që kanë nxënësit në lexim dhe në shkrim. Po ashtu, edhe rezultatet e vlerësimit të parë, me anë të testit PISA, treguan se 77% e nxënësve në Kosovë nuk arrijnë nivelin bazë të zotësisë në lexim. Analizat e shumta tregojnë se ka nevojë urgjente për ofrimin e mbështetjes për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe në lexim.

Për të parë se cilat janë vështirësitë e nxënësve në shkrim-lexim, si dhe mundësitë e ofrimit të mbështetjes për nxënësit me vështirësi, realizuam studim të veçantë, qëllimi i të cilit ishte identifikimi i vështirësive, si dhe mundësitë e tejkalimit të tyre si rezultat i mbështetjes së ofruar.

Në këtë drejtim, kemi shqyrtuar kornizën teorike në lidhje me vështirësitë e nxënësve, përvoja të trajtuara nga autorë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë për vështirësitë e nxënësve në shkrim dhe në lexim, dokumente zyrtare të hartuara nga MASHT-i, përvoja të rëndësishme të nxënësve dhe mësimit në Kosovë, duke mbledhur kështu informacione të rëndësishme për vështirësitë në shkrim dhe në lexim, llojet e vështirësive, identifikimin e tyre, mbështetjen e nxënësve për eliminimin e vështirësive, si dhe mundësitë për parandalimin me kohë të tyre.

Rezultatet janë produkt i të dhënave të mbledhura nga nxënësit dhe mësimit në shkollë, me mostër prej 940 nxënës dhe 103 mësimit në shkollë pjesëmarrës në studim, analizës së dosjeve të nxënësve të realizuara me udhëheqjen e mësimit në shkollë dhe monitorim të punës së mësimit në shkollë me nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim. Studimi u realizua me nxënësit e dhjetë shkollave, në tri komuna: Drenas, Malishevë dhe Hani i Elezit.

Rezultatet e studimit tregojnë se nxënësit përballen me vështirësi në shkrim-lexim. Vështirësitë e tyre fillojnë që nga njohja dhe emërtimi i shkronjave, shqiptimi i tingujve, pastaj formimi i rrokjeve, fjalëve e fjalive, vështirësitë në kuptimin e leximit, dhe në drejtshkrim.

Nxënësit me vështirësi kanë nevojë për mbështetje shpesh nga ana e mësimit në shkollë. Kjo u vërtetua nga përkrahja e ofruar në shkollë mësimit në shkollë u ndihmoi në organizimin dhe realizimin e punës plotësuese me nxënësit, ndërsa për nxënësit ofrimi i ndihmës përmes mësimit plotësues ndihmoi në përmirësimin e shkathtësisë në shkrim dhe në lexim. Rezultatet po ashtu tregojnë se identifikimi me kohë i nxënësve me vështirësi dhe ofrimi i përkrahjes për ta ndihmon në përmirësimin e shkathtësisë të nxënësve në shkrim-lexim, apo edhe në tejkalimin me kohë të vështirësive, dhe kështu u ofron mundësi nxënësve të ecin në hap me të tjerët.

Fjalët çelës: *nxënës, arsimi fillor, vështirësi, shkrim, lexim*

ABSTRACT

Reading and writing are skills being developed since the first grade in Primary Education. In recent years, much has been discussed about the serious problem students have in reading and writing. Also, the results of the first assessment by the PISA test showed that 77% of students in Kosovo do not reach basic reading proficiency. Numerous analyzes indicate that there is an urgent need to provide support for students with reading and writing difficulties.

To see what the students' reading and writing difficulties are, as well as the opportunities to provide support for students with learning difficulties, we conducted a special study aimed at identifying students' reading and writing difficulties and overcoming opportunities as a result of the support provided.

In this regard, we have examined the theoretical framework regarding students' difficulties, experiences addressed by various local and international authors on students' literacy difficulties, official documents drafted by MEST, important experiences of Kosovar students and teachers, thus collecting important information on reading and writing difficulties, types of difficulties, identifying them, supporting students in eliminating difficulties, and opportunities for timely prevention.

The results are the product of data collected from a sample of 940 students and 103 teachers participating in the study, analysis of student files conducted with teacher guidance, and monitoring of teacher work with students with reading and writing difficulties.

The results of the study show that students face difficulties in writing and reading. Their difficulties start from recognizing and naming letters, pronouncing sounds, then forming syllables, words and sentences, difficulties in reading comprehension and spelling.

Students with disabilities need additional support from teachers. The support provided in schools helped teachers in organizing and implementing complementary work with students, while for students, providing support through complementary learning helped improve writing and reading skills. The results also show that timely identification of students with disabilities and providing support for them helps improve students' literacy skills or overcomes difficulties and thus provides opportunities for students to keep up with others.

Keywords: *students, primary school, difficulties, writing, reading*

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1. Vështirësitë karakteristike për disgrafinë
- Tabela 2. Rezultatet e të nxënit të fushës Gjuhët dhe komunikimi, përmes të lexuarit dhe të shkruarit, për shkallën e parë
- Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë Shqipe (sistemi gjuhësor), klasa e parë
- Tabela 4. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë Shqipe, për konceptin tekste letrare dhe joletrare, klasa e dytë
- Tabela 5. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë Shqipe, për konceptin sistemi gjuhësor, klasa e dytë
- Tabela 6. Rezultatet e të nxënit të fushës Gjuhët dhe komunikimi, përmes të lexuarit dhe të shkruarit, për shkallën e dytë
- Tabela 7. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë Shqipe, për konceptin tekste letrare e joletrare, për klasën e tretë
- Tabela 8. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë Shqipe, për konceptin sistemi gjuhësor, klasa e tretë
- Tabela 9. Pjesëmarrësit e përfshirë në studim
- Tabela 10. Model i pyetjeve nga testi i leximit
- Tabela 11. Të dhëna demografike për pjesëmarrësit e përfshirë në studim
- Tabela 12. Rezultatet e nxënësve në vlerësimin e parë
- Tabela 13. Rezultatet e nxënësve sipas pikëve të marra në vlerësimin e parë në shkrim
- Tabela 14. Nxënësit e klasës së tretë me rezultate nën mesatare në lexim dhe në shkrim, në vlerësimin e parë
- Tabela 15. Të dhëna nga nxënësit e klasës së katërt, të cilët nuk u treguan të suksesshëm në vlerësimin e parë
- Tabela 16. Të dhëna përshkruese për rezultatet e nxënësve të klasës së katërt në vlerësimin e parë

- Tabela 17. Nxënësit e klasës së pestë, të cilët nuk u treguan të suksesshëm në vlerësimin e parë
- Tabela 18. Të dhëna përshkruese për rezultatet e nxënësve të klasës së pestë në vlerësimin e parë
- Tabela 19. Të dhëna për nxënësit e përfshirë në vlerësimin e dytë
- Tabela 20. Rezultatet e nxënësve në vlerësim, të dala nga vlerësimi i dytë
- Tabela 21. Nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim, sipas klasave
- Tabela 22. Të dhëna përshkruese për fëmijët me vështirësi dhe radhës së fëmijëve në familje
- Tabela 23. Suksesi i nxënësve dhe llojet e vështirësive në shkrim
- Tabela 24. Qëndrimet e nxënësve lidhur me pyetjen se çfarë dhe si u pëlqen të lexojnë
- Tabela 25. Të dhëna përshkruese lidhur me kohën e leximit të nxënësve gjatë javës
- Tabela 26. Plani i veprimit, i hartuar nga stafi i shkollës për aktivitetet me nxënësit e identifikuar me vështirësi në shkrim-lexim
- Tabela 27. Plani orientues i punës me grupet e nxënësve me vështirësi
- Tabela 28. Të dhëna përshkruese lidhur me orët e planifikuara për mësim plotësues
- Tabela 29. Numri i nxënësve të përfshirë në punë plotësuese, sipas orëve
- Tabela 30. Rezultatet e nxënësve në vlerësimin e tretë në shkrim-lexim
- Tabela 31. Krahasimi i rezultateve të nxënësve sipas klasave

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1.** Ushtrime shkrimi me nxënësin e klasës së tretë
- Figura 2.** Dallimi ndërmjet rezultateve të nxënësve në lexim-shkrim
- Figura 3.** Sa orë lexojnë nxënësit gjatë javës?
- Figura 4.** Fleta pune të përdorura me nxënës
- Figura 5.** Përdorimi i materialeve mësimore gjatë punës me nxënës

SHKURTESAT

MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
RNF	Rezultatet e të Nxënit për Fushë
RNL	Rezultatet e të Nxënit për Lëndë
PIA	Plani Individual i Arsimit
EGRA	Vlerësimi i leximit në klasat e hershme
A-EGRA	Vlerësimi i leximit në klasat e ulëta në gjuhën shqipe
FSIESK	Mbështetja Finlandeze për Sistemin e Arsimit Gjithëpërfshirës në Kosovë
FSDEK	Mbështetja Finlandeze për Zhvillimin e Sektorit të Arsimit në Kosovë
SPSS	Pakoja Statistikore për Studimet Sociale

HYRJE

Përvetësimi i shkrim-leximit themelor është veçori e arsimit fillor. Elementet themelore të leximit dhe shkrimit, bazuar në kurrikulën bërthamë, përvetësohen në shkallën e parë të arsimit fillor, që nënkupton se në shkallën e dytë të arsimit fillor nxënësit do të kenë përvetësuar shkrim-leximin themelor. Deri më tani, janë zhvilluar studime të ndryshme lidhur me vështirësitë e nxënësve në shkrim-lexim, si dhe janë hartuar e realizuar programe trajnimi për përgatitjen e mësimit të nxënësve që të punojnë me vështirësi. Në dekadën e fundit, në shkolla u ofruan vlerësime të bazuara në vlerësimet ndërkombëtare, të cilat treguan se nxënësit tanë nuk e arrijnë nivelin bazë të zotësisë në shkrim-lexim.

Studimi ndërlidhet me prioritetet strategjike të përcaktuara me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë, 2017-2021, nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, dhe kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e rezultateve të nxënësve në shkrim-lexim, si dhe në zhvillimin profesional të mësimit të nxënësve në aspektin e përqendrimit të vëmendjes së shtuar ndaj nxënësve me vështirësi.

Studimi u realizua krahas ofrimit të mbështetjes së mësimit të nxënësve në kuadër të projektit “Mbështetja e mësimit të nxënësve në identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim dhe ofrimin e mbështetjes për tejkalimin e tyre”.

Studimi ofron të dhëna të rëndësishme, të cilat janë mbledhur përmes analizës së literaturës shkencore, analizës së dokumenteve që lidhen me shkathhtësitë e shkrim-leximit, matjes/vlerësimit të shkathhtësive të nxënësve në shkrim-lexim të nxënësve të shkollës së dytë të arsimit fillor, si dhe analizës së mundësive të tejkalimit të tyre, si rezultat i mbështetjes së ofruar. Studimi ofroi mundësi që gjatë një viti shkollor mësimit të nxënësve të shkollave të përfshira në studim, në mbështetje të IPK-së, të angazhohen në identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim, planifikim dhe organizim të punës plotësuese me nxënësit me vështirësi. Identifikimi me kohë të vështirësive në shkrim dhe në lexim është shumë me rëndësi,

ngase ndihmon mësimdhënësit në planifikimin adekuat të punës me nxënës dhe rrit mundësinë e zvogëlimit apo eliminimit të vështirësive.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Leximi dhe shkrimi janë shkathtësi, të cilat te fëmijët fillojnë të zhvillohen qysh në moshë të re, por në mënyrë të planifikuar te nxënësit zhvillohen që nga klasa e parë. Janë shkathtësi themelore, të cilat nxënësve ua hapin shtigjet e arsimimit dhe u ofrojnë qasje të pavarur në një botë të gjerë të informacionit.

Leximi përkufizohet si një proces njohës, që përfshin dekodimin e simboleve për të arritur kuptim, ndërsa shkrimi si sistem i shenjave të posaçme grafike, që përdoret për të paraqitur ligjërimin e folur, për të shkruar në një gjuhë të caktuar (www.fjalorshqip.com).

Studime të ndryshme japin versione të ndryshme lidhur me leximin dhe shkrimin, disa vënë në pah marrëdhëniet e rëndësishme mes shkronjave, fjalëve, fjalive dhe tekstit, të tjera i referohen gjuhës së folur, më saktësisht kuptimit të saj.

Fëmijët që fitojnë aftësi për kodim alfabetik fillojnë të njohin shumë fjalë (Stanovich, 1986). Dëshifrimi ose leximi i fjalëve është aftësi e nevojshme për nxënësit (Hoover & Gough, 1990), e gjithashtu edhe të kuptuarit, i cili përfshin analizën e informacionit gjuhësor të tekstit të dhënë.

Aftësitë e gjuhës së folur janë të rëndësishme, për shkak se ofrojnë një bazë për të lexuar. (Treiman, 2018). Sipas këtij studimi, elementet e para të leximit fëmijët i mësojnë nga leximi që ua bëjnë atyre të rriturit. Kur të rriturit u lexojnë fëmijëve që ende nuk mund të lexojnë vetë, fëmijët u kushtojnë vëmendje gjuhës që dëgjojnë dhe fotografive në libër. Një gjë e tillë nxit dhe motivon fëmijët për të lexuar. Pra, aftësitë specifike të kërkuara për lexim dhe shkrim mund të vijnë edhe nga përvojat paraprake të të folurit dhe këto përvoja motivojnë fëmijët për të punuar drejt mësimin, për të lexuar dhe për të shkruar. Nga këto përvoja mësojnë se

leximi dhe shkrimi janë mjete të vlefshme, që do t'i ndihmojnë ata të bëjnë shumë gjëra në jetë.

Studime të ndryshme flasin për marrëdhënien e leximit dhe shkrimit, si dy shkathtësi të nevojshme jo vetëm për suksesin akademik të nxënësve, por edhe për jetën e tyre sociale.

Hulumtuesit e Departamentit të Psikologjisë dhe Qendrës për Studime të Leximit në Florida hulumtuan marrëdhëniet midis leximit dhe shkrimit në nivelin e fjalës, fjalisë dhe tekstit. Sipas tyre, marrëdhëniet lexim-shkrim ishin më të fortat në nivelin e fjalisë dhe se leximi është përcaktues i shkrimit (Ahmed et al., 2014). Aftësia e të shkruarit shfaqet si një burim i rëndësishëm i dallimeve individuale në shpjegimin e aftësisë së përgjithshme të leximit. Shkathtësitë e leximit dhe të shkrimit janë të lidhura ndërmjet vete, sepse ato mbështeten në themel të ngjashëm (Jenkins et al., 2004), e që baza ose themeli i shkrimit dhe leximit janë shkronjat/tingujt. Rëndësia e aftësive të shkrimit të shkronjave mbështetet në prova empirike, që tregojnë se aftësia për të shkruar shkronja është një parashikues i shkëlqyeshëm i drejtshkrimit (Sparapani et al., 2018). Sipas këtij hulumtimi, leximi mund të ndikojë në performancën e shkrimit dhe në kushte të caktuara edhe aftësia e shkrimit mund të ndikojë në performancën e leximit, p.sh. nëse hasim lexues me aftësi të kufizuara (siç i quajnë autorët e studimit), atëherë është e rëndësishme të përcaktohet nëse aftësia e kufizuar rezulton nga një dobësi në deshifrim apo dobësi në të kuptuar, ose (siç ka shumë të ngjarë) dobësi në të dyja aftësitë e kufizuara.

Mësimi i leximit dhe mësimi i shkrimit janë dy procese, të cilat kërkojnë angazhim dhe mbështetje të vazhdueshme të nxënësve. Me gjithë moshën e njëjtë, të dy këto procese mund të mos zhvillohen njësoj te të gjithë nxënësit. Te disa nxënës zhvillohen dukshëm më ngadalë, ngase paraqiten vështirësi, edhe pse nxënësit janë me aftësi mesatare intelektuale. Vështirësi të tilla mund të paraqiten qysh në klasën e parë, të cilat mund të thellohen në klasën e dytë, dhe pastaj ta përcjellin nxënësin edhe në pjesën tjetër të shkollimit.

Në fjalorin e gjuhës shqipe, termi vështirësi shpjegohet si diçka që kërkon shumë mund, përpjekje apo punë për ta bërë ose për ta arritur; pengesë që është e vështirë për t'u kapërcyer; gjendje e vështirë. Pengesa të tilla te nxënësit mund të paraqiten edhe në shkrim dhe në lexim.

Një numër i konsiderueshëm i nxënësve shfaqin vështirësi në të lexuar. Madje, konsiderohet se, nga numri i përgjithshëm i nxënësve që kanë vështirësi në të nxënë, rreth 80% e tyre kanë vështirësi në të lexuar (Zabeli, 2004, f. 15).

Vështirësitë në lexim kanë të bëjnë me pengesat që paraqiten te nxënësit në procesin e bashkimit të shkronjave, rrokjeve, të lexuarit automatik të fjalëve, vështirësitë në shpejtësi, rrjedhshmëri, saktësi, ose të kuptuarit e asaj që lexon.

Hulumtimet ndërkombëtare tregojnë se në vende të ndryshme të botës është në rritje shqetësimi lidhur me mungesën e aftësive të nevojshme të nxënësve për lexim. Studimet e bëra në vende të ndryshme, lidhur me vështirësitë në lexim të nxënësve në fazën e themelimit të shkollave gjithëpërfshirëse, tregojnë se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 40% e fëmijëve përjetojnë probleme të rëndësishme për t'u bërë lexues kompetentë dhe 40% e klasës së katërt dhe klasës së tetë nuk arrijnë të lexojnë në nivelin e konsideruar, lexim themelor për punën në shkollë. Studimi tjetër në Guinea Frankofone tregon se vetëm një në dhjetë nxënës e dinte tërë alfabetin deri në fund të klasës së dytë dhe nxënësi mesatar mund të lexonte vetëm katër nga 20 fjalët e paraqitura. Në Peru, sipas një studimi të bërë nga Abadzi, në vitin 2008, u zbulua se vetëm 25% e nxënësve të klasës së parë dhe 45% e nxënësve të klasës së dytë ishin në gjendje të lexonin alfabetet e vetme dhe fjalë të thjeshta.

Në Maqedoni, në vitin 2016, u organizua studimi për vlerësimin e shkrim-leximit fillestar në fushë të gjuhës dhe njohurive themelore matematikore në klasat fillestare, në të cilin u përfshinë nxënës nga klasa e dytë dhe e tretë, nga të gjitha shkollat fillore me mësim në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke (USAID, FDCI, 2016). Sipas këtij studimi, nxënësit treguan rezultate të mira në fushën e shqiptimit të saktë të shkronjave, por

shkathtësitë e tyre për kuptimin e tekstit të lexuar nuk janë të zhvilluara sa duhet, pa marrë parasysh gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi.

Një vlerësim i tillë, Testi A-EGRA, në Kosovë për herë të parë u pilotua në vitin 2012, nga Programi për Arsim Themelor (BEP), kur u përdor njëra nga tri format pilot për testimin e leximit të 800 nxënësve nga 40 shkolla partnere të BEP-it në fund të klasës së dytë. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të vendoset një nivel për arritshmërinë në lexim, përmes së cilës të vlerësohet puna e programit në këtë fushë, por edhe të mblidhen informata për nivelet mesatare dhe diversitetin e arritshmërisë për shkathtësi të ndryshme të leximit. Studimi vërtetoi se nxënësit në Kosovë arrijnë standard të mirë në disa fusha. Për shembull, pothuajse të gjithë nxënësit i mësojnë mirë shkronjat, ndërsa shumica (rreth 75%) kanë aftësi për ta përdorur këtë njohuri për dekodimin e jofjalëve. Por, sipas studimit, ka hapësirë për përmirësim në fushat e tjera. Më e rëndësishmja nga këto është rrjedhshmëria dhe leximi me kuptim. Në të dyja këto fusha, pothuajse 40% e nxënësve janë “në rrezik” (BEP, 2014).

Vlerësim tjetër për nxënësit e arsimit fillor në Kosovë u organizua nga projekti “Mbështetja finlandeze për sistemin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë, 2011-2013”, përmes të cilit, në vitin 2012, janë vlerësuar 516 nxënës të arsimit fillor (klasat 1-5), në 17 shkolla të ndryshme në Kosovë. Rezultatet e vlerësimit tregojnë se një numër relativisht i madh i nxënësve në klasën e dytë dhe të tretë akoma nuk kanë mësuar të lexojnë (FSIESK, 2013).

Studimi ka treguar se edhe dhënia e mbështetjes së përshtatshme për nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim përmirëson shumë shpejt shkathtësitë e tyre të leximit dhe të shkrimit dhe se mbështetja individuale e dhënë për nxënësit që kanë pasur vështirësi në lexim dhe në shkrim ka dhënë rezultate të mira në përmirësimin e shkathtësive të leximit dhe të shkrimit (FSIESK, 2013). Sipas këtij studimi, mësimdhënësit duhet të trajnohen si të identifikojnë, si të mbështesin dhe si të krijojnë materiale alternative për punë individuale me këta nxënës brenda dhe jashtë klasës së tyre.

Studimet lidhur me identifikimin e nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim janë kritikuar vazhdimisht për shkak të gabimeve të mundshme në matje. Për këtë arsye, identifikimi i vështirësive të nxënësve në shkrim dhe në lexim duhet të bazohet në vlerësime të vazhdueshme, në periudha të ndryshme kohore.

Dallimet ndërmjet nxënësve me vështirësi dhe nxënësve me nevoja të veçanta

Kur flasim për nxënësit me vështirësi në mësim, jo në të gjitha rastet u referohemi nxënësve me nevoja të veçanta. Vështirësitë në të nxënë kanë të bëjnë me pengesat e nxënësve që paraqiten gjatë të nxënit, të cilat shkaktohen nga faktorë të ndryshëm.

Nxënësit me vështirësi kanë potencial për të arritur nivele të përshtatshme për moshën, ndërsa nxënësit me aftësi të kufizuara në të nxënë kanë vështirësi në fusha të veçanta të arritjeve akademike, si rezultat i dëmtimit të një ose më shumë proceseve njohëse që lidhen me të mësuarit.

Veçori e një paaftësie specifike mësimore është se vështirësia vazhdon të ekzistojë, pavarësisht udhëzimeve dhe ndërhyrjeve të përshtatshme (Learning Difficulties, 2014).

Një vështirësi mësimore mund të mos ketë asnjë lidhje me inteligjencën e një nxënësi, ndërsa nxënësi me aftësi të kufizuara mund të ketë vështirësi që janë të natyrshme për fëmijën dhe janë të përjetshme.

Vështirësitë e nxënësve në lexim

Leximi fillon me shqiptimin e tingujve, dëgjimin, kuptimin e fjalëve dhe përdorimin e tyre. Leximi është proces kompleks i deshifrimit të simboleve për të nxjerrë kuptimin. Është mjet për përvetësimin e gjuhës, komunikimin, shkëmbimin e informacionit dhe ideve.

Leximi është i rëndësishëm për të mësuar, pasi u jep nxënësve qasje të pavarur në një botë të gjerë të informacionit, si dhe përmbushje dhe kënaqësi. (*Gunning, 2007*)

Mësimi i leximit lidhet ngushtë me njohjen e shkronjave, shqiptimin dhe leximin e tyre.

Shumica e njerëzve mësojnë të lexojnë pa vështirësi, e disa të tjerë mund të hasin në vështirësi, mund të kenë nevojë për ndihmë shtesë.

Rreth 10 milionë fëmijë kanë vështirësi të mësojnë të lexojnë. Lajmi i mirë është se më shumë se 90 për qind e lexuesve me vështirësi mund të kapërcejnë vështirësitë e tyre nëse marrin trajtim të duhur në moshat e hershme.

(*Kathryn Drummond,*

Vështirësia në të lexuar, e quajtur disleksi, është paaftësia e individit për të përvetësuar aftësitë e leximit. Ajo nuk është vështirësi që shkaktohet nga shqetësimet emocionale, motivim i pamjaftueshëm, metodologji e papërshtatshme e mësimdhënies, prapambetje mendore, dëmtime në të dëgjuar apo në të parë, por është bazë neurologjike, dëmtime të mundshme të trurit, të cilat shkaktojnë probleme të shumta në procesin e të lexuarit e më gjerë. Ajo është një konditë e përhershme, e cila e përcjell personin gjatë gjithë jetës, por që me përkrahje të duhur personat dislektikë mund të arrijnë suksese të mjaftueshme (Zabeli, N., 2014, f. 15). Disleksia ndikon në leximin dhe aftësinë e përpunimit të bazuar në gjuhë. Mund të ndikojë në leximin rrjedhshëm, në deshifrim, në të kuptuarit e leximit, në

drejtshkrim, e nganjëherë edhe në të folur dhe çrregullime tjera të ndërlydhura (Learning Disabilities Association of Amerika, 2014).

Nxënësit me disleksi shfaqin probleme të llojllojshme, si: vështirësi në dallimin e tingujve apo shkronjave që kanë ngjashmëri apo edhe të numrave, si b=d, c=ç, p=q, 6=9, 1=11, vështirësi në lidhjen e tingujve me simbolin e shkronjave, vështirësi në orientim hapësinor në tekste të shkruara, lënie përgjysmë e fjalëve gjatë leximit dhe përgjithësisht lexim i dobët, vështirësi në të mbajturit mend të porosive dhe interpretimit të udhëzimeve, vështirësi në gjetjen e fjalëve adekuate, në dhënien e ideve, krahasimin e tyre etj. (Zabeli, Z., 2014).

Në përmbledhjen e udhëzimeve për parandalimin e vështirësive në lexim, nga Departamenti i Edukimit në Shtetet e Bashkuara u identifikuan tri arsye për vështirësitë në lexim: probleme në të kuptuarit dhe përdorimin e parimit alfabetik, për të lexuar saktë fjalë dhe aftësi për të lexuar rrjedhshëm, mungesën e njohurive dhe shkathtësive verbale, që janë konkretisht të nevojshme për të kuptuar materialin e shkruar, si dhe mungesën ose humbjen e motivimit për lexim (Snow et al., 1998).

Edhe përcjellja e tekstit gjatë leximit duket të jetë një tregues i cilësisë së të kuptuarit të përmbajtjes së leximit. Duke mos qenë në gjendje të lexojë mirë, nga e majta në të djathtë dhe nga lart poshtë, do të thotë që fëmija juaj do të përdorë dy herë sasinë e kohës për të rikthyer hapat e tyre. Kjo më vonë sjell vështirësi me të kuptuarit, pasi gjithë fuqia e trurit të fëmijës suaj do të fokusohet në ndjekjen e tekstit, jo në kuptimin e mesazhit.

Vështirësitë e nxënësve në shkrim

Përvetësimi i elementeve themelore të shkrimit, në mënyrë kreative dhe të organizuar, fillon që nga klasa përgatitore. Shkathtësitë e shkrimit fëmija duhet t'i përvetësojë deri në përfundim të shkallës së parë të arsimit fillor.

Në përvetësimin e shkathtësive të shkrimit, rol të veçantë ka institucioni/shkolla, e cila në mënyrë të planifikuar dhe të organizuar, përmes përmbajtjeve kurrikulare, e ka për detyrë të zhvillojë aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve në shkrim.

Të mësuarit e shkrimit lidhet ngushtë me njohjen e shkronjave, shqiptimin dhe shkrimin e tyre, si dhe me gramatikën. Nuk është e mjaftueshme që nxënësi të dijë të shkruajë shkronja e fjalë, por është e rëndësishme që shkronjat dhe fjalët e shkruara t'i lidhë gradualisht, duke ndërtuar struktura më komplekse. Megjithatë, formimi i shprehive të shkruarit, drejt dhe pa gabime gjuhësore, kërkon jo vetëm njohjen e strukturës gramatikore të shqipes standarde, por edhe një punë këmbëngulëse e sistematike...(Memushaj, R., 2005).

Shkrimi është mjet i rëndësishëm i komunikimit, mësimit dhe të shprehurit. Shkrimi u ndihmon nxënësve të shprehin mendime, ide, dhe është mënyrë efektive për t'i shprehur ato. E rëndësishme është që secili individ të përvetësojë shkathtësitë e shkrimit dhe të synojë një shkrim të qartë e të lexueshëm. Njerëzit, të cilët kanë vështirësi të theksuara të shkrimit, përballen me sfida të shumta gjatë arsimimit, zhvillimit profesional dhe punësimit të tyre. Pothuajse 70 për qind e punonjësve me paga kanë të paktën disa përgjegjësi për të shkruar dhe aftësia për të shkruar mirë është një komponentë kritike, për të qenë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive për një audiencë të ndryshme. Shkrimi është një mjet i vlefshëm për komunikim, mësim, dhe vetë-shprehje, pasi njerëzit që nuk kanë aftësitë adekuate të shkrimit mund të jenë në disavantazh dhe mund të përballen me mundësi të kufizuara të arsimit dhe punësimit (NCEE, 2012). Nuk ka mësimdhënës që në punën e vet nuk është ndeshur me nxënës, të cilët kanë vështirësi në të shkruar (Zabeli, N.,

2004, f. 16). Vështirësitë e tilla mund të jenë të ndryshme dhe të shkaktuara nga faktorë po ashtu të ndryshëm.

Vështirësia në të shkruar, e njohur me termin *disgrafi*, është paaftësi e fëmijës për ta përvetësuar shkathtësitë e të shkruarit, e cila vërehet nëpërmjet gabimeve të shumta dhe tipike, të cilat nuk janë të lidhura me mosdijen e drejtshkrimit, si dhe me shkallën e zhvillimit intelektual shprehës, e cila, sipas shkaqeve, mund të jetë trashëguese, e fituar nga faktorë të jashtëm jo të përshtatshëm në zhvillim, apo e kombinuar (Byroja për zhvillimin e Arsimit, 2017). Sipas këtij doracak, vështirësitë e nxënësve me disgrafi kanë të bëjnë me shkronjat dhe rrokjet, fjalët dhe fjalitë.

Tabela 1. Vështirësitë karakteristike për disgrafinë

Gabime me fushën e shkronjave dhe rrokjeve	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Lëshime (shkronja-shkrnja; karrige-karrge), ➤ Zhvendosje – veshtiresi në vëzhgimin e rradhitjes së shkronjave në fjalë (akoma-kaoma; personi;presoni), ➤ Të shtuarit e shkronjave fletore-fletore; mjegulla-mjegualla), ➤ Perseveracioni – ngaterrimi, perseritja e shkronjave ose rrokjeve (mbeturinambeturinana) ➤ Anticipimi shpejtimi para - kur tingulli i nevojshem zevendesohet me tingull tjetër i cili është prezent në fjalën vijuese (“gogor” - logor).
Gabime në fushën e fjalëve	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shkruarit e ndarë të fjalës së njejtë (mbi vlerësim), ➤ Të shkruarit e formuar nga dy fjalë (nëndegë), ➤ Fjalë të derdhura-mospatja e kufinjëve.
Gabime në fushën e fjalëve	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Lidhja e fjalëve në fjali, ➤ Interpunktimi jo i rregullt

Vështirësitë e nxënësve në shkrim mund të jenë të lidhura edhe me vështirësitë e nxënësve në lexim. Nxënësit ndeshen edhe me vështirësinë

e ashtuquajtur *disortografia*, e cila ka të bëjë me vështirësinë e të shkruarit të gjuhës që ata flasin. Kjo është e lidhur me disleksinë ku vështirësitë në të lexuar barten edhe në të shkruar” (Zabeli, N., 2004, f. 17).

Disortografia është çrregullim specifik në shkencën e shkrimit, duke u shfaqur si një gabim drejtshkrimi, me gjithë njohjen e rregullave të drejtshkrimit dhe motivimit të duhur për shkrimin e saktë. Mund të korrigjohet, megjithatë zhdukja e plotë e simptomave është e rrallë (<https://educalingo.com>).

Megjithatë, jo të gjitha problemet në të shkruar shfaqen si pasojë e disgrafisë dhe disortografisë. Nxënësit kanë nevojë për ushtrime, për të zhvilluar aftësitë e shkrimit. Ushtrimet janë të vlefshme, sepse ndihmojnë nxënësit të njohin shkronjat, të mendojnë në mënyrë kritike për shkronjat, të organizojnë ato në shkrimin e fjalëve, organizimin e fjalëve në fjali dhe fjalive në tekste të ndryshme.

Analiza e dokumenteve zyrtare, të hartuara nga MASHT-i

Me *Kornizën kurrikulare* të arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, janë përcaktuar kompetencat kryesore, të cilat duhet të zhvillohen dhe të arrihen nga të gjithë nxënësit deri në përfundim të shkollimit të mesëm të lartë (MASHT, 2016).

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit është një nga gjashtë kompetencat e parapara në Kornizën kurrikulare, rezultatet e së cilës ndihmojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim dhe në lexim.

Kurrikula Bërthamë - Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja përmes të lexuarit dhe të shkruarit

Me *Kurrikulën Bërthamë* për klasën përgatitore dhe arsimin fillor janë përcaktuar rezultatet e të nxënët për fushën Gjuhët dhe komunikimi. Këto rezultate përmbajnë kërkesa që nxënësi duhet t’i arrijë pas përfundimit të çdo shkalle. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë e nxënësve që duhet

të zhvillohen dhe të thellohen përmes shkrimit dhe leximit gradualisht, për shkallën e parë dhe të dytë, janë:

Tabela 2. Rezultatet e të nxënës të fushës Gjuhët dhe komunikimi, përmes të lexuarit dhe shkruarit, për shkallën e parë

	Të lexuarit	Të shkruarit
	Nxënësi/ja	Nxënësi/ja
Shkalla 1 - Klasa përgatitore, I, II (mosha 5-8)	1. Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë si dhe elementet e përdorimit të gjuhës;	1. Përkshkruan tekste sipas modeleve dhe shkruan për të komunikuar idetë e veta me të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive dhe teksteve të shkurtra;
	2. Lexon me zë tregim të shkurtër dhe përdor pjesë plotësuese të tekstit (foto, vizatim etj.);	2. Praktikon teknika që janë specifike për krijime përkatëse dhe i përdor në aktivitete të caktuara;
	3. Zhvillon shkathtësitë për të lexuarit e kuptimshëm;	3. Shkruan tekste shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;
	4. Përflet apo parafrazon tekste që ka lexuar;	4. Vizaton diçka të thjeshtë mbi bazë imagjinare dhe shkruan disa fjali për përmbajtjen e figurës që ka vizatuar;
	5. Identifikon elementet kryesore të një teksti të shkurtër: ngjarjen, personazhet etj., dallon gjuhën figurative (metaforike) nga ajo jofigurative. Jep përshtypje në lidhje me një tekst të shkurtër letrar a joletrar;	5. Shkruan fjalët duke parë figura;
	6. Identifikon të dhënat kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta;	6. Shkruan fjali të thjeshta në kohën e tashme, të kryer dhe të ardhme;
	7. Lexon rregulla elementare dhe përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve, ekspozitave në klasë dhe paraqitjeve para ekranit;	7. Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë;
	8. Lexon materiale të ndryshme nga mjete audio-vizuale.	8. Përdor drejt shenjat kryesore të pikësimit;
		9. Përdor teknologjinë informative (për të shkruar fjalë, fjali, numra, simbole, tinguj,

Rezultatet e të nxënit për fushën Gjuhët dhe komunikimi (RNF) përmbajnë kërkesa që nxënësit duhet t'i arrijnë pas përfundimit të çdo shkalle, ndërsa rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), janë përcaktuar në planet dhe programet zyrtare të hartuara nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, për secilën klasë. Në planet dhe programet mësimore për lëndën Gjuhë Shqipe janë përcaktuar konceptet, temat dhe rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL).

Në klasën përgatitore fokusi është në shkathtësitë e komunikimit, të cilat te fëmijët e kësaj moshe arrihen përmes të folurit, vizatimeve, këngës dhe lojës. Në këtë fazë, fëmijët dëgjojnë dhe kuptojnë informata, mesazhe, këshilla, ngjarje, tregime apo përralla, interpretojnë ato me ndihmën e ilustrimeve, fotografive, objekteve e figurave, shqiptojnë drejt tinguj, fjalë e fjali gjatë të shprehurit, flasin për tema të ndryshme, këndojnë e luajnë role bazuar në modele, duke përdorur fjalë dhe shprehje të ndryshme. Në klasën përgatitore fëmijët mësojnë edhe elementet e para të leximit dhe të shkrimit. Bazuar në kurrikulën lëndore/programin mësimor për klasën përgatitore, përvetësimi i elementeve bazike të shkathtësive të komunikimit, në mesin e të cilave hyjnë edhe të shkruarit dhe të lexuarit, bëhet përmes mësimin të integruar të fushave lëndore, ndërsa në klasën e parë shkrimi dhe leximi mësohen përmes lëndës së gjuhës.

Në klasën e parë, nxënësit identifikojnë, shqiptojnë dhe shkruajnë shkronja, vazhdojnë me shqiptimin e drejtë të rrokjeve e të fjalëve, shkrimin e leximin e fjalive dhe teksteve. Në këtë klasë nxënësit mësojnë tingujt, shenjat, shkronjat, simbolet, si dhe elementet bazë të sistemit gjuhësor.. Po ashtu, pasurojnë fjalorin, aftësohen në mënyrë sistematike për të shkruar dhe për të lexuar... Nëpërmjet përmbajtjeve, nga tekstet e thjeshta dhe ilustrimet, nxënësit njohin dhe kuptojnë lidhjen e tingujve, shkronjave, rrokjeve, fjalëve e fjalive me ilustrime dhe fotografi të ndryshme (MASHT, 2018, f. 9).

Elementet kryesore të shkrimit dhe të leximit në klasën e parë kryesisht arrihen përmes rezultateve e temave të përcaktuara, nëpërmjet sistemit gjuhësor, që mësimdhënësi duhet ta realizojë nëpërmjet shkathtësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë shqipe (sistemi gjuhësor), klasa e parë

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Sistemi gjuhësor	Tingujt	<ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
	Shkronjat	
	Rrokjet	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon rrokjen në fjalë;
	Fjala	<ul style="list-style-type: none"> • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla; • Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë;
	Fjalia	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor drejt shenjat e pikësimi: pikën, presjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen etj.;
	Shenjat e pikësimit	<ul style="list-style-type: none"> • Shkruan drejt fjalët, fjalitë, dhe i shqipton me intonacionin
	Intonacioni	
	Foljet ndihmëse kam dhe jam	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton dhe dallon foljet ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme; • Kupton, dallon dhe përdor drejt emrin, mbiemrin dhe përemrin;
	Emri, mbiemri, përemri	<ul style="list-style-type: none"> • Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit; • Shkruan fjalë duke parë figura; • Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat; • Identifikon mjetet audio-vizuale dhe ato të teknologjisë informative dhe i përdor për të dëgjuar, për të komunikuar dhe për të bërë regjistrime; • Bën vizatime të thjeshta mbi bazë imagjinare dhe shkruan fjali për përmbajtjen e figurës që ka vizatuar; • Përdor lojën për të mësuar; • Lexon tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse.

Për t'u bërë lexues dhe shkruer të mirë, nxënësit duhet të kenë bazë të fortë të njohjes dhe të shqiptimit të shkronjave/tingujve. Nxënësit duhet të

mësojnë emrat e shkronjave të alfabetit dhe shqiptimin e tyre, të lidhin tingullin me shkronjën përkatëse. Kur e kuptojnë lidhjen mes shkronjave dhe tingujve të tyre, ata do të mund të kuptojnë se shkronjat e vendosura bashkë formojnë fjalë. Nëse nxënësi arrin ta kuptojë këtë, do të thotë se i ka kuptuar elementet kryesore të leximit, ngase ky është themeli i leximit. P.sh. para nxënësit vendosim shkronjat: D O R A. Shqiptojmë me radhë tingujt D-O-R-A, pastaj gjatë shqiptimit bashkojmë ata dhe formohet fjala DORA.

E njëjta gjë ndodh edhe gjatë shkrimit. Shkrimi lidhet shumë me shqiptimin dhe leximin, ngase nxënësi gjatë procesit të shkrimit i dikton vetes atë çfarë shkruan (në heshtje apo me zë të lartë). Prandaj, është shumë e rëndësishme që nxënësit të njohin e të emërtojnë shkronjat, të shqiptojnë drejt tingujt e gjuhës shqipe, dhe të shkruajnë drejt fjalë, shprehje globale, dhe fjali të thjeshta.

Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve për leximin dhe shkrimin rriten vazhdimisht, nga klasa në klasë. Në klasën e dytë nxënësit zgjerojnë njohuritë e tyre, ngase jo vetëm që lexojnë fjali, por edhe dallojnë llojet e fjalive, gjininë e numrin e emrave dhe mbiemrave, si dhe kohët kryesore të foljeve.

Elementet kryesore të shkrimit dhe të leximit në klasën e dytë kryesisht arrihen përmes rezultateve e temave të përcaktuara, nëpërmjet koncepteve: tekste letrare dhe joletrare dhe sistemit gjuhësor, që mësimdhënësi duhet t'i realizojë nëpërmjet shkathtësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Në tabelën më poshtë janë paraqitur temat dhe rezultatet e të nxënësve të lëndës për temë, për lëndën Gjuhë Shqipe, për konceptin tekste letrare dhe joletrare dhe konceptin sistemi gjuhësor, koncepte këto që, përmes rezultateve të tyre, kontribuojnë direkt në përvetësimin e shkrim-leximit.

Tabela 4. Rezultatet e të nxënimit për lëndën Gjuhë shqipe, për konceptin tekste letrare e jo letrare, klasa e dytë

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënimit të lëndës për temë (RNL)
Tekste letrare dhe joletrare	<ul style="list-style-type: none"> • Poezia, përrallëza, përralla, tregime, tekste të thjeshta dramatike, tekste të ndryshme të karakterit njohës, edukativ dhe dokumentar, gjëgjëza, fjalë të urta, urime, letra të thjeshta porosi, falënderime, letra, adresa, ftesa, njoftime, shënime personale. Festa, koha e lirë, profesione. • Elementet themelore të rimës, dialogut, vargut e prozës, përmes shembujve 	<ul style="list-style-type: none"> • Përcakton tiparet themelore të përrallës, përrallëzës, tregimit, poezisë; • Krahason poezinë me gjëgjëzën, përrallën me tregimin; • Lexon rrjedhshëm fragmente të ndryshme nga tekste letrare dhe joletrare; • Lexon me zë tregime, përralla, përrallëza të shkurtra e poezi, duke bërë krahasime me fotografi, vizatime e ilustrime përkatëse; • Diskuton për fjali, thënie dhe rrëfime të ndryshme; • Ritregon dhe komenton ngjarje të lexuara, të rrëfyera, si dhe ngjarje nga situata jetësore; • Demonstron kulturën e të shprehurit dhe të menduarit e pavarur; • Shprehet në forma të ndryshme për temë të njëjtë; • Shpreh botën emocionale me fjalë të zgjedhura; • Shpreh mendimet dhe emocionet personale rreth pjesës që lexon; • Dallon tekstet themelore letrare dhe joletrare; • Dallon idenë themelore nga detajet; • Ritregon dhe vlerëson tekste letrare dhe joletrare; • Dallon personazhet, ngjarjet dhe përfundimin; • Dallon ritmin, rimën, dialogun; • Dallon tekstet reale nga tekstet e imagjinuara. • Flet dhe lexon me intonacionin e duhur (theksi, ritmi); • Emërton disa lloje të teknologjisë informative dhe flet për përdorimin e tyre.

Tabela 5. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë shqipe, për konceptin sistemi gjuhësor, klasa e dytë

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Sistemi gjuhësor	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëtingëlloret: dh-ll, ç-q, xh-gj, b-d, r-rr, etj. • Shqiptimi i drejtë i tingujve, rrokjeve, fjalëve; fjalitë dëftore, pyetëse, pohore dhe mohore • Gjinia, numri i emrave dhe mbiemrave; • Përemri vetor; • Kohët kryesore të foljeve: e kryer, e tashme dhe e ardhme; • Fjalitë dëftore, pyetëse, pohore dhe mohore; • Veprime brenda fjalisë: zëvendësime, shtesa, heqje; • Përdorimi i shkronjës së madhe; • Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit; • Shenjat e pikësimit në fund të fjalisë (. , ?!) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipton drejt tingujt, rrokjet dhe fjalët; • Shqipton me intonacionin e duhur fjalët dhe fjalitë; • Shkruan drejt e qartë dhe përdor shenjat e pikësimit; • Dallon bashkëtingëlloret në të shqiptuar; • Dallon kategoritë gramatikore të emrit dhe mbiemrit (gjinia, numri); • Identifikon llojet kryesore të fjalive; • Zbaton rregullat e drejtshkrimit; • Identifikon dhe përdor kohët kryesore të foljeve <i>kam</i> dhe <i>jam</i> sipas kohëve kryesore (dje, sot, nesër); • Zgjedhon foljet në kohën e tashme; • Shkruan tekste të shkurtra sipas modeleve; • Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe te emrat e përveçëm; • Dallon dhe përdor përemrat vetorë; • Shkruan fjali dëftore, pyetëse, pohore dhe mohore; • Zgjeron apo shkurton fjalinë; • Ndan saktë fjalët në fund të rreshtit; • Përdor drejt shenjat e pikësimit.

Sa i përket leximit, nxënësi në klasën e dytë lexon rrjedhshëm tregime, përralla, përrallëza të shkurtra e poezi, ritregon, diskuton, komenton tekstet e lexuara, dallon tekstet reale nga tekstet e imagjinuara. Deri në përfundim të shkallës së parë, nxënësi mëson elementet bazë të shkrimit

dhe të leximit. Pra, mëson të shkruajë e të lexojë drejt, rrjedhshëm dhe pa gabime.

Tabela 6. Rezultatet e të nxëniet të fushës Gjuhët dhe komunikimi, përmes të lexuarit dhe të shkruarit, për shkallën e dytë

Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathhtësitë, që zhvillohen te nxënësi/ja përmes të lexuarit dhe të shkruarit	
Të lexuarit	Të shkruarit
<p><i>Nxënësi/ja</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përdor strategji për të kuptuar materialet e lexuara letrare apo joletrare: poezi, prozë, letër, biografi, lutje, raport, 2. Identifikon pjesën themelore të ngjarjeve të tregimeve të lexuara me zë, duke përdorur fjalë të rëndësishme ose objekte vizuale (fotografi, vizatime etj.), si dhe identifikon kategoritë gramatikore 3. Dallon tekstet letrare nga ato joletrare; 4. Interpreton vepra letrare, duke nisur nga komentimi i ngjarjes, ideve, personazheve, rrëfimit, figurave, si: hiperbola, litota, metafora, dhe nxjerr një përfundim për tekstin letrar apo joletrar (për poezinë, tregimin, pjesën dramatike, raportin, reklamën, biografinë etj.); 5. Përdor strategjinë e lexim-kuptimit, duke interpretuar idenë kryesore të një teksti dhe duke e dalluar atë nga detajet; 6. Zhvillon aftësitë imagjinative dhe kreative; 7. Identifikon kategoritë gramatikore në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare. 	<p><i>Nxënësi/ja</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Praktikon formën e caktuar të një teksti letrar apo joletrar; 2. Zhvillon aftësinë e korigjimit të gjuhës së teksteve; 3. Shkruan një tekst të thjeshtë (ese, tekst të ndryshëm); 4. Shkruan lloje të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare, për tema të caktuara; 5. Shkruan për një situatë imagjinare; 6. Shkruan, sipas dëshirës apo me detyrë, tekste që promovojnë vlera të individit e të shoqërisë, lojës, ambientit, familjes, shkollës etj. 7. Përdor rregulla të drejtshkrimit; 8. Përdor drejt shenjat e pikësimit; 9. Përdor teknologjinë informative (kompjuterin, printerin) për të shkruar dhe vlerësuar një tekst, ngjarje, personazh apo ide

Shkalla 2 - Klasa III,IV,V (mosha 8-11)

Klasa e tretë synon arritje të vërejtur te nxënësi në zhvillimin e aftësive në gjuhë, në lexim dhe shkrim; rritje të rrjedhshmërisë në lexim, ndërtim të strategjisë së shkrimit, njohje të formulave, me të cilat fillon e vazhdon një shkrim, pasurimi i fjalorit, shkrimi i fjalive të përbëra, më të gjata (MASHT, 2018).




Figura 1. Ushtime shkrimi me nxënësin e klasës së tretë

Nxënësi në këtë moshë lexon edhe tekste të ndryshme me intonacion të duhur, përgjigjet në pyetjet e parashtruara rreth brendisë së tekstit, identifikon elemente të teksteve të shkurtra letrare dhe joletrare, analizon dhe vlerëson tekste të shkurtra letrare dhe joletrare... rrëfen dhe shkruan për veten, për dëshirat dhe ambiciet...nxjerr porosinë nga teksti përmes dialogut që zhvillojnë personazhet, shkruan tekste të shkurtra mbi bazën e modeleve, shkruan tekste dhe mesazhe të thjeshta që lidhen me çështjet e jetës së përditshme. Këto janë rezultate të pritshme për nxënësin e klasës së tretë në lëndën e Gjuhës shqipe, për konceptin tekste letrare dhe joletrare.

Tabela 7. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë shqipe, për konceptin tekste letrare e joletrare, klasa e tretë

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Tekstet letrare dhe joletrare	<p>Tregime, poezi, tekste të shkurtra dramatike, përrallëza, përralla, fjalë të urta, gjëegjëza;</p> <p>Proza, pjesa skenike - dallimet (vargu, dialogu, shkrimi në prozë);</p> <p>Jeta në klasë, në shkollë, në shtëpi, në rreth;</p> <p>Orientimi në hapësirë;</p> <p>Rrëfime personale: koha e lirë, dëshirat, shqetësimet dhe ambiciet e tyre;</p> <p>Festa, urime, falënderime, letra, adresa, ftesa, porosi, njoftime;</p> <p>Mediat: radio, TV, revistat për fëmijë;</p> <p>Kinema, teatër.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lexon tekste të ndryshme me intonacionin e duhur; • Përgjigjet në pyetjet e parashtruara rreth brendisë së tekstit; • Identifikon elemente të teksteve të shkurtra letrare dhe joletrare; • Analizon dhe vlerëson tekste të shkurtra letrare dhe joletrare; • Dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare dhe në tekstet joletrare; • Dallon disa elemente të tekstit dramatik si: skenat, aktet, grupin e personazheve, fjalët e personazheve; • Rrëfen dhe shkruan për veten, për dëshirat dhe ambiciet; • Krijon rregulla dhe jep këshilla për veprime të gabuara; • Orientohet në hapësirë dhe në ambiente të ndryshme; • Nxjerr porosinë nga teksti përmes dialogut që zhvillojnë personazhet; • Shkruan tekste të shkurtra mbi bazën e modeleve; • Shkruan tekste dhe mesazhe të thjeshta që lidhen me çështjet e jetës së përditshme; • Identifikon pikat kryesore të bisedave të thjeshta dhe tregimeve të lexuara me zë, duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta; • Dallon gjuhën e medieve dhe karakteristikat e tyre (informacioni i marrë nga radio, nga TV dhe nga revistat/gazetat); • Ndjek, diskuton dhe përshkruan subjektin e një filmi, pjesë teatrale, dokumentari; • Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja.

Rezultatet e të nxënit që lidhen me sistemin gjuhësor ndihmojnë në përvetësimin e kategorive gramatikore, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në avancimin e shkrim-leximit. Në klasën e tretë nxënësi dallon llojet e emrave, përdor drejt përemrat, përdor fjali të llojeve të ndryshme, zbaton veprime brenda fjalisë, shkruan tekste, si dhe zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit.

Tabela 8. Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë shqipe, për konceptin sistemi gjuhësor, klasa e tretë

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Sistemi gjuhësor	Emra të përveçëm dhe të përgjithshëm; Trajta e emrave; Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; Përemrat vetorë; Numërori; Foljet në kohën e tashme, të ardhme, të kryer dhe të pakryer të mënyrës dëftore; Ndajfolja e kohës, e vendit dhe e mënyrës; Parafjalët: me, nga, prej, më, në; Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e zgjeruar, gjymtyrët kryesore dhe të dyta; Lidhja dhe përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën Llojet e fjalive: dëftore, pyetëse dhe habitore; Drejtskrimi.	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon kategoritë gramatikore të fjalëve (gjinia, numri); • Dallon emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm; • Dallon emrat në trajtën e shquar dhe të pashquar; • Identifikon mbiemrin; • Dallon mbiemrat e nyjshëm nga ata të panyjshëm; • Identifikon dhe përdor drejt përemrat vetorë; • Dallon numërorët themelorë nga ata rreshtorë; • Identifikon foljet dhe zgjedhon ato në kohët kryesore të dëftores; • Identifikon ndajfoljet dhe pyetjet me të cilat gjenden ato; • Dallon disa nga parafjalët më të përdorshme; • Identifikon pjesët kryesore të fjalisë; • Shpreh marrëdhëniet e kryefjalës me kallëzuesin; • Identifikon dhe përdor fjali të llojeve të ndryshme: dëftore, pyetëse, habitore; • Përdor drejt emrat e përveçëm, mbiemrat, foljet numërorët dhe parafjalët; • Rishikon dhe vlerëson qartësinë e shkrimit për të përmirësuar përmbajtjen;

-
- Dallon bashkëtingëlloret në të shqiptuar;
 - Zbaton veprime brenda fjalisë (heq, shton ose zhvendos fjalë në fjali pa e prishur kuptimin e saj);
 - Përshkruan objekte mbi bazën e modeleve;
 - Shkruan tekst të shkurtër sipas modeleve dhe figurave të dhëna;
 - Zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit;
 - Përdor drejt shenjat e pikësimit, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit dhe shkronjën e madhe;
 - Dallon llojet e fjalive sipas shenjave të pikësimit;
 - Shkruan drejt e qartë dhe përdor shenjat e pikësimit.
-

Plani dhe programi mësimor për klasën e katërt kryesisht janë të orientuar në shkrimin dhe leximin me kuptim. Nxënësi në klasën e katërt lexon tekste të ndryshme, me intonacionin e duhur, me ritmin e nevojshëm, i zbërthen ato, kupton dhe ritregon tekstin në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, dallon tekstet letrare nga tekstet joletrare, tekstet zyrtare nga tekstet jozyrtare (lajmërimin, arsyetimin, falënderimin, kërkesën, formularët e ndryshëm, shpalljet publike etj.), dallon poezinë nga proza, tonalitetin, ritmin, vargun, strofën, tregimin fantastik, tregimin realist, përshpejton të lexuarit dhe aftësinë e të lexuarit në heshtje.

Sa i përket shkrimit, nxënësi në këtë moshë, përveçse shkruan fjalë, fjali e tekste drejt dhe pa gabime, shkruan edhe për ngjarje të ndryshme, paraqet idetë e tij përmes shkrimit, jep mendime me shkrim lidhur me ngjarje të ndryshme, zgjeron njohuritë gjuhësore për emrat, mbiemrat, përemrat, lidhëzat, ndajfoljet, rrethanaorët, kundrinorët, ligjëratën, si dhe i përdor ato drejt gjatë shkrimit (MASHT, 2005).

Në klasën e pestë nxënësi lexon me zë apo në heshtje dhe zbërthen tekste letrare dhe joletrare, kupton natyrën e teksteve, i parafrazon, i interpreton dhe i identifikon sipas natyrës së shkrimit dhe tematikës së tyre... Me

ushtrime përvetëson gradualisht të lexuarit shprehës dhe interpretativ, duke respektuar shenjat e pikësimit, ndalesat, theksin logjik, ritmin, tempin diksionin, intonacionin. Përmes të lexuarit nxënësi përvetëson gjuhën. Gjatë leximit, kupton dallimin e tekstit dhe fjalisë, ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë, kupton fjalinë, njeh llojet e fjalive, si dhe të gjitha kategoritë tjera gramatikore. Gjithashtu, gjatë të lexuarit aktiv përvetëson dhe zgjeron fjalorin vetjak, si dhe praktikon përdorimin e fjalorit.

Edhe të shkruarit në këtë moshë avancohet. Përveçqë shkruan drejt dhe pa gabime, krijon dhe shkruan për nevoja vetjake, përmes përdorimit të modeleve, letra, biografi, autobiografi, poezi, tregime, ditarë, korrespondenca, artikuj të thjeshtë, dhe shfaq me shkrim mendime për një film, shfaqje, ekspozitë, dhe për situata të ndryshme jetësore (MASHT, 2005, f. 25-28).

Në përfundim të shkallës së dytë, nxënësi shkruan dhe lexon tekste të ndryshme, letrare dhe joletrare, shkruan për qëllime të ndryshme personale, lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre, duke përdorur gjuhën standarde. Përdor strategji, para, pas dhe gjatë leximit, për të kuptuar dhe për të komentuar tekstin që lexon.

Identifikimi i vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim

Identifikimi i vështirësive në shkrim dhe në lexim mund të bëhet në forma të ndryshme. Forma më e shpeshtë e vlerësimit të shkathtësive dhe identifikimit të vështirësive bëhet përmes vlerësimit të përditshëm që i bëhet nxënësit, bazuar në kritere objektive dhe rezultate mësimore të përcaktuara me kurrikulën lëndore për klasën përkatëse. Mësimdhënësit vlerësojnë nxënësit për arritjet e tyre gjatë gjithë procesit të mësimnxënies, sigurojnë informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së rezultateve mësimore.

Për fushën Gjuhët dhe komunikimi vlerësimi duhet të përqendrohet në përvetësimin themelor të shkrim-leximit, si dhe në të dëgjuarit aktiv. Përdorimi i të kuptuarit të asaj që dëgjon-lexon për të shfaqur mendimin e tij, duke përdor fjalë të reja, si dhe angazhimi në tekste të shkruara për të zhvilluar njohuritë e fituara.

Vlerësimi i shkrim-leximit bëhet si zbërthim i leximit me zë të lartë dhe përdoret me qëllim, për të matur atë që është më e gjerë dhe më e thellë, siç është qëndrimi për atë që lexon.

Vlerësimi në këtë fushë vë theksin në mbledhjen e informacioneve nga të mësuarit, të kuptuarit e tekstit (dallimin e elementeve bazë të teksteve letrare dhe joletrare), përdorimin e thjeshtë të fjalëve me kuptim figurativ, paraqitjen e qartë të mendimeve, lidhjen dhe përmbledhjen e tyre.

Po ashtu, duhet të përqendrohet te të shprehurit e qartë, të saktë (drejtshqiptimi dhe drejtshkrimi), në formë të pavarur dhe kreative. Vlerësimi duhet të përfshijë raportimin e informacionit të marrë për performancën e leximit dhe shkrimit, dëgjimit aktiv, gjatë punës në grupe, dhe duhet të njohë karakteristikat njohëse së bashku me ato motivuese të sjelljes, në të shprehurit me gojë ose me shkrim (MASHT, 2016).

Gjatë vlerësimit dhe përcjelljes sistematike, mësimdhënësit mund të identifikojnë edhe nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim. Mirëpo, identifikimi më i saktë i vështirësive në shkrim dhe lexim bëhet përmes instrumenteve të hartuara për këtë qëllim.

Në Kosovë, gjatë viteve të fundit, janë përdorur lloje të ndryshme të instrumenteve për identifikimin e vështirësive në shkrim dhe në lexim, teste të hartuara nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, të përshtatura me kontekstin kosovar. Ndër testet e përdorura janë edhe EGRA dhe pakoja e instrumenteve të hartuara nga Räsänen, Tahiraj, projekt i realizuar nga KAPIE & FSDEK II - Përkrahja Finlandeze për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë.

Testi EGRA, instrument për vlerësimin e leximit, u hartua në vitin 2006 dhe është përdorur në më shumë se 50 shtete, në 70 gjuhë të ndryshme.

Hartimi dhe përdorimi i tij në Kosovë filloi në vitin 2012. Vlerësimi i leximit në klasat e ulëta në Gjuhën Shqipe (A-EGRA) u hartua nga Programi për Arsimin Themelor (BEP), i përkrahur nga USAID-i (BEP, Vlerësimi i leximit në klasat e hershme (A-EGRA), maj 2014, f. 9).

Ndërsa, pakoja e instrumenteve të hartuara nga Räsänen, Tahiraj, të cilën e kemi përdorur në studim, përmban instrumente për vlerësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim, si testet grupore për vlerësimin e nxënësve dhe testin individual.

Në setin e testeve grupore bëjnë pjesë testi për vlerësimin e rrjedhshmërisë në lexim dhe testi i shkrimit. Testi për vlerësimin e leximit mat rrjedhshmërinë në lexim dhe në një masë të caktuar edhe shpejtësinë në lexim dhe të kuptuarit e leximit. Koha e testimit me anë të këtij testi zgjat 3 minuta dhe duhet të matet saktë, me anë të orëmatësit. Pas përfundimit të 3-minutëshit, nxënësi duhet të ndërpresë leximin. Testi është hartuar për dy grupe, A dhe B, në të cilat ka pak ndryshime në radhitjen e fjalive (Instituti Niilo Mäki, Pekka Räsänen, Gazmend Tahiraj, Mbështetja Finlandeze për Sistemin e Arsimit Gjithëpërfshirës në Kosovë, 2011-2013, testi për rrjedhshmëri në lexim).

Testi i shkrimit mat njohuritë e nxënësve në shkrimin e fjalëve. Ky instrument përdoret në grup me nxënësit, në formë të diktimit, dhe mësimdhënësi apo testuesi dikton fjalët, ndërsa nxënësit shkruajnë. (Pekka Räsänen, P., Tahiraj, G., Mbështetja Finlandeze për Sistemin e

Arsimit Gjithëpërfshirës në Kosovë, 2011-2013, Instituti Niilo Mäki, testi i shkrimit).

Të dyja testet e përmendura më lart, përveç fletës së testit për nxënës, përcillen edhe me udhëzime të qarta për testuesit, të detajuara për secilin hap që duhet të ndiqet para dhe gjatë testimit, si: materialet e nevojshme për nxënësin, materialet e nevojshme për mësimsdhënësin apo testuesin, udhëzimet që duhet të jepen për nxënësit që testohen, deri te përfundimi i testimit.

Pakoja përfshin edhe testin individual të leximit, i cili mat shkathhtësitë e leximit për fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Është hartuar me detyra individuale, të cilat japin një vlerësim të shkathhtësive në leximin e fjalëve dhe aftësive që lidhen me leximin, të cilat formojnë bazën e të nxënësit me anë të leximit në shkollë dhe janë shkathhtësi të rëndësishme për të lexuarit me kuptim (Räsänen P., Tahiraj, G., 2008).

Testi individual i leximit përbëhet prej 4 komponentëve, të cilët matin drejtpërdrejt shkathhtësitë e leximit: përpunimi fonologjik (heqja e rrokjeve dhe bashkimi i fonemave), njohuritë për shkronjat (njohja dhe emërtimi i shkronjave), leximi (leximi i fjalëve dhe pseudofjalëve) dhe emërtimi i shpejtë serik (ESHS).

Puna me nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim

Puna me nxënës kërkon angazhim dhe përkushtim dhe mësimdhënësi e ka rolin kryesor në arsimimin e nxënësve të tij. Ai mbështet nxënësit të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, në harmoni me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë. Kjo është kërkesë e kurrikulës dhe qëllim i arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës (Korniza Kurrikulare, 2016).

Edhe në procesin e përvetësimit të leximit dhe të shkrimit, mësimdhënësit e kanë rolin kryesor në klasë, duke u mësuar nxënësve se si të lexojnë e të shkruajnë, duke qenë edhe vetë një model i mirë për ta. Mësimi i leximit dhe shkrimit nuk është proces i lehtë për nxënësit. Është proces që kërkon punë e përkushtim qysh në ditët e para të arsimimit të fëmijëve.

Fillimisht mësimdhënësit i duhet të vlerësojë njohuritë paraprake të nxënësve. Periudha përgatitore, e cila zgjat 3-4 javë në fillim të klasës së parë, i ndihmon mësimdhënësit të vlerësojë njohuritë fillestare të nxënësve dhe të përgatisë ata për fillimin e mësimi të shkrim-leximit. Kryesisht kjo fazë lidhet me aftësimin e nxënësve për të shqiptuar dhe për të lexuar drejt tingujt e gjuhës shqipe, duke i lidhur me shkronjën përkatëse (shih udhëzimet e dhëna në programin e lëndës së gjuhës shqipe-abetare, klasa I, Cikli fillor i shkollës 9-vjeçare, hartuar nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë 2003, f. 11).

Edhe puna me nxënës jashtë orëve të rregullta mësimore ndihmon në plotësimin e njohurive dhe shkathtësive në shkrim dhe në lexim. Mësimi plotësues organizohet nga mësimdhënësi i klasës/lëndës, para ose pas orarit të rregullt mësimor. Mund të organizohet në fillim të vitit shkollor, në fillim të pushimeve semestrale, si dhe gjatë vitit shkollor/mësimor. Zakonisht zhvillohet krahas punës së rregullt mësimore (IPK, 2014, f. 82). Huluntimi i realizuar për gjendjen e planifikimit dhe realizimit të mësimi plotësues për nxënësit e arsimit fillor në Kosovë tregon se mësimi plotësues nuk është pjesë përbërëse, e obligueshme, e planifikimit të shkollës (IPK, 2014). Sipas rezultateve të hulumtimit në fjalë, mësimdhënësit mbajnë mësim plotësues me nxënës varësisht prej nevojës,

pa planifikim paraprak, por e rregullojnë në baza individuale. Varësisht prej nevojave të nxënësve, mësime dhënësit planifikojnë dhe organizojnë mësim plotësues. Sipas studimit në fjalë, mësimi plotësues kryesisht organizohet për nxënësit e klasës së dytë, në lëndët Gjuhë Shqipe dhe Matematikë, por nuk mbahet rregullisht. Varësisht nga nevoja, mësime dhënësi i cakton nxënësit dhe vazhdon mësimin pas përfundimit ose para fillimit të mësimin të rregullt. Huluntimi nxjerr rekomandim për mësime dhënësit, që mësimin plotësues ta planifikojnë dhe ta realizojnë përmes lëndës zgjedhore (kurrikulës me zgjedhje). Kjo është një mundësi shumë e mirë që mësime dhënësit të zgjedhin përmbajtjet mësimore, të cilat do të ishin me interes për nxënësit. Në këtë mënyrë, rezultatet e lëndës me zgjedhje do të ndikojnë në rezultatet e të nxënit në fushën/lëndën përkatëse, si dhe mësimi plotësues do të realizohet brenda orarit të rregullt mësimor, duke mos pasur më si vështirësi vendin e mbajtjes së mësimin plotësues, që sipas huluntimit ishte sfidë e mësime dhënësvë për realizimin e mësimin plotësues.

Qëllimi i studimit

Studimi kishte për qëllim identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim, si dhe mundësitë e tejkallimit të tyre si rezultat i mbështetjes së ofruar.

Pyetjet e studimit

Studimi u fokusua në dy çështje kryesore: identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim dhe në lexim, si dhe ofrimin e ndihmës për eliminimin e vështirësive të nxënësve.

Përmes shqyrtimit të literaturës, dokumenteve zyrtare dhe studimit në terren, siguroam përgjigje në pyetjet huluntuese:

- Si mund të identifikohen vështirësitë në shkrim-lexim?
- Cilat janë vështirësitë e nxënësve në shkrim-lexim?
- A ndihmon puna plotësuese, mbështetja shtesë e ofruar për nxënësit, në eliminimin e vështirësive në shkrim-lexim?

Nevoja për realizimin e projektit

Planifikimi dhe realizimi i projektit të studimit u iniciua bazuar në nevojat dhe kërkesat e mësimit të nxënësve për mbështetje, për identifikimin dhe tejkalimin e vështirësive të nxënësve në mësim, me theks të veçantë vështirësitë në shkrim dhe në lexim. Pavarësisht punës me ta, ndihmës dhe mbështetjes që iu ofrohet nga ana e mësimit të nxënësve, jo të gjithë fëmijët mund të arrijnë nivelin e duhur të arritjeve në shkrim-lexim. Për disa nxënës, procesi i leximit, i shkrimit, apo të dyja proceset, mund të jenë të vështira për t'i nxënë. Si rrjedhojë, mësimit të nxënësve e panë të rrugës të mobilizohen në nivel shkollor për identifikimin e vështirësive që nxënësve kanë në të lexuar dhe në të shkruar, të planifikojë mënyrën e tejkalimit të tyre. Shkollat, përmes DKA-ve, iu drejtuan Institutit Pedagogjik të Kosovës me kërkesë për ofrim të mbështetjes për mësimit të nxënësve. Mbi këtë bazë, Instituti Pedagogjik i Kosovës ofroi projektin “Mbështetja e mësimit të nxënësve në identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim dhe ofrimin e mbështetjes për tejkalimin e tyre”.

Pas mbështetjes së ofruar përmes projektit, u shtrua nevoja për të parë efektin e mbështetjes së mësimit të nxënësve në identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve në tejkalimin e vështirësive të tyre në shkrim-lexim.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Studimi është i tipit të përzier, sasiore dhe cilësor. Përmes instrumenteve të studimit, kemi mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore për rezultatet e nxënësve të përfshirë në studim, numrin e nxënësve që kanë vështirësi në shkrim-lexim, llojet e vështirësive, dhe mundësitë e parandalimit dhe eliminimit të tyre. Studimi ishte me kohëzgjatje prej një viti shkollor, studim rasti. U realizua në mënyrë sistematike në shkollë, në bashkëpunim me stafin e shkollës.

Për këtë, fillimisht ishte e nevojshme të bëhet (i) rishikim i literaturës, në të dyja formatet, elektronike dhe të shtypura, si: libra, raporte, studime, artikuj gazetash dhe revista; (ii) analizë të dokumenteve zyrtare që kanë të bëjnë me zhvillimin e shkathtësive në shkrim dhe në lexim, përmbajtjet e ofruara dhe rezultatet e pritura nga nxënësit, (iii) mbledhja e të dhënave përmes instrumenteve vlerësuese për nxënës, me qëllim vlerësimin e shkathtësive në shkrim-lexim, si dhe pyetësorëve për mësimdhënës, me qëllim të analizimit të praktikave të mësimdhënësve për përmirësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim.

Studimi kaloi nëpër tri faza kryesore:

Faza e parë - Studimi i literaturës, konteksti i shkollave, dhe përgatitja materialeve dhe instrumenteve për vlerësim.

Në këtë fazë bëmë studimin e literaturës, dokumenteve dhe burimeve tjera që kanë të bëjnë me leximin dhe shkrimin, analizën e studimeve, përvojave vendore dhe ndërkombëtare. lidhur me identifikimin e vështirësive në shkrim-lexim, si dhe finalizimin e instrumenteve të vlerësimit dhe pilotimin e tyre.

Faza e dytë – Përzgjedhja e shkollave, përgatitja dhe ofrimi i mbështetjes për mësimdhënës.

Në bashkëpunim me komunat, u identifikuan shkollat për përfshirje në projekt dhe u analizua konteksti i tyre. U organizuan takime me zyrtarët e arsimit në komuna dhe takime informuese me udhëheqësit dhe personelin mësimor të shkollave të përfshira në projekt. Takimi i parë me stafin e shkollës kishte për qëllim informimin e tyre lidhur me aktivitetet e

projektit. Meqë projekti ishte njëvjeçar dhe aktivitetet e projektit zgjatën një viti shkollor, ishte e nevojshme edhe diskutimi me stafin e shkollave lidhur me planifikimin e aktiviteteve.

Në shkolla u bë organizimi i punëtorive dyditore për mësimdhënës, lidhur me:

- *Vështirësitë në shkrim-lexim* - aspektet konceptuale lidhur me vështirësitë në shkrim-lexim, dallimet mes nxënësve me vështirësi dhe nxënësve me nevoja të veçanta, llojet e vështirësive, karakteristikat e nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim;

- *Identifikimi i nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim* - përdorimi i instrumenteve të vlerësimit për identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim;

- *Organizimi i punës për nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim* - krijimi i grupeve të leximit dhe të shkrimit, puna plotësuese me to, hartimi dhe zbatimi i planit individual për punë me nxënës me vështirësi në shkrim-lexim;

- *Materialet didaktike që ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive në shkrim-lexim* - hartimi i materialeve didaktike dhe përdorimi i tyre me nxënës.

Organizimi dhe realizimi i punëve praktike të mësimdhënësve me nxënësit u bë nën udhëheqjen e koordinatorit të projektit me bazë në shkollë, si dhe e tërë puna u monitorua nga trajnerët dhe hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës, me përkrahjen e koordinatorit për cilësi në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

Në bashkëpunim me mësimdhënësit, në shkolla u organizuan vlerësimet për nxënës, përmes së cilave u bë identifikimi i nxënësve me vështirësi dhe mësimdhënësit filluan punën plotësuese me nxënës, me qëllim të mbështetjes së tyre për përmirësimin e shkathtësive në shkrim-lexim.

Faza e tretë - Mbështetja, analiza e vlerësimi i rezultateve të nxënësve gjatë dhe pas mbështetjes së ofruar.

Gjatë kohës së ofrimit të mbështetjes për nxënësit nga mësimdhënësit në shkollat e tyre, si formë e mësimi plotësues, u bënë edhe monitorimi dhe mentorimi i vazhdueshëm i mësimdhënësve gjatë punës me nxënës.

Pas përfundimit të mësimi plotësues, analizuam planet, raportet dhe dosjet e mësimdhënësve për punën/aktivitetet plotësuese me nxënës me vështirësi, ofruam mbështetje për ta, vlerësimin nxënësve të përfshirë në aktivitete plotësuese, si dhe ofrimin i informatës kthyesë të mësimdhënësit për rezultatet e dala nga analiza e planeve, raporteve, dosjeve dhe rezultateve të nxënësve.

Popullacioni dhe mostra

Popullacionin e studimit e përbëjnë të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit e arsimit fillor, në komunat Malishevë, Drenas dhe Hani i Elezit, ndërsa për mostër kemi përzgjedhur nxënës dhe mësimdhënës të arsimit fillor. Me qëllim të përcjelljes sistematike, mostra është e vogël.

Mostra është dyshtresore, e përbërë nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

Tabela 9. Pjesëmarrësit e përfshirë në studim

Komunat	Numri i Mësimdhënës shkollave		Nxënës								Gjithsej nxënës	
			Klasa e tretë		Klasa e katërt		Klasa e pestë					
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%		
Malishevë	4	41	33.9	88	27.1	87	29.5	80	25.0	255	27.1	
Drenas	3	32	26.4	87	26.7	53	18.0	89	27.8	229	24.4	
Hani i Elezit	3	48	39.7	150	46.2	155	52.5	151	47.2	456	48.5	
Mostra	10	121	100.0	325	100.0	295	100.0	320	100.0	940	100	

Studimin e realizuam me rreth 10 % të popullacionit, që do të thotë se në mostër u përfshinë 940 nxënës dhe 121 mësimdhënës të arsimit fillor, në

10 shkolla të përzgjedhura nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, në komunat Malishevë, Drenas dhe Hani i Elezit.

Arsyeja pse jemi kufizuar vetëm në këto komuna është se studimi është veprues dhe implementohet gjatë një viti shkollor. Përveç punës me nxënës, kërkon edhe zhvillimin profesional të mësimit dhe materiale didaktike, të cilat mësimit i përdorin gjatë punës me nxënës, gjë që kushtëzohet edhe nga mjetet financiare. Për këtë arsye, studimi është kufizuar vetëm në komunat që kanë ofruar mbështetje për zhvillimin profesional të mësimit dhe materiale për shkollat, të cilat ato i kanë përzgjedhur të përfshihen në projekt.

Përzgjedhja e shkollave - Shkollat u përzgjedhën nga Drejtoritë Komunale të Arsimit. Përzgjedhja u bë varësisht prej nevojës dhe mundësive që kanë DKA-të për të ofruar mbështetje. Në diskutim me DKA-të është siguruar mbështetja për këto 10 shkolla. Përzgjedhja e shkollave u bë pa ndonjë kriter të caktuar paraprakisht. Meqë mbështetja e shkollave ishte kërkesë nga komunat e cekura më lart, shkollat u përzgjedhën nga DKA-të. Mostra e përzgjedhur është dyshtesore, e përbërë nga mësimit dhe nxënës të arsimit fillor.

Përzgjedhja e mësimit - Përfshihen të gjithë mësimit e arsimit fillor në shkollat e përzgjedhura. Për përzgjedhjen e mësimit, ishin dy kritere kryesore: të jenë mësimit në arsimin fillor dhe të jenë pjesë e stafit të shkollave të përzgjedhura.

Përzgjedhja e nxënësve - Ishte po ashtu e rastësishme, ngase u përfshinë nxënës nga klasa e tretë, klasa e katërt dhe klasa e pestë (shkalla e dytë e arsimit fillor) të shkollave të përfshira në studim. Përzgjedhja u bë e tillë, ngase nxënësit e shkollës së dytë të arsimit fillor (klasa e tretë, klasa e katërt dhe klasa e pestë) llogaritet se tashmë i kanë mësuar shkathtësitë e shkrimit dhe të leximit. Në klasën e tretë nxënësit duhet të bëhen lexues të suksesshëm, që të jenë në gjendje të shkruajnë e të lexojnë drejt dhe pa gabime. Ndërsa, nuk u përfshinë nxënësit e shkollës së parë, respektivisht nxënësit e klasës së parë dhe të dytë, ngase llogaritet se nxënësit e kësaj moshe janë në proces të mësimit të shkrimit-leximit.

Instrumentet për studim

Për mbledhjen e të dhënave u shërbyem me teste dhe me pyetësorë.

a) Mbledhja e të dhënave nga nxënësit u bë me teste dhe me pyetësorë.

Për vlerësimin e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim, përdorëm instrumentet e zhvilluara nga ekspertë vendorë dhe të huaj. Këto instrumente në Republikën e Kosovës, për qëllimin e njëjtë, përdoren që nga viti 2012. Pëlqimi për përdorimin e tyre është marrë nga autorët e testeve.

Për vlerësimin e nxënësve përdorëm dy lloje të testeve: testet grupore dhe testet individuale.

1. Testet grupore për identifikimin e vështirësive, po ashtu, janë dy llojesh: testi i leximit dhe testi i shkrimit.

1.1. Testi i leximit mat rrjedhshmërinë dhe kuptimin e leximit. Nxënësi ka për detyrë të lexojë fjalinë dhe në anën e djathtë të qarkojë njëren nga shkronjat, S (që do të thotë saktë) dhe G (që do të thotë gabim).

Tabela 10. Model i pyetjeve nga testi i leximit

Qumështi nuk mund të pihet.	S	G
Arrat mund të flasin.	S	G

Me qëllim që nxënësi të ketë mundësi të japë sa më shumë përgjigje, në test janë ofruar 70 fjali. Nuk është obligative që nxënësi të përgjigjet në të gjitha. Minimumi i përgjigjeve caktohet varësisht nga mosha dhe klasa e nxënësit.

1.2. Testi i shkrimit mat shkathtësitë e nxënësve në drejtshkrim. Fëmijës i diktohen fjalë. Lista e fjalëve përmban 20 fjalë, në nivele të ndryshme të vështirësisë. Secila fjalë diktohet dy herë brenda 20 sekondave. Në mesin

e tyre ka fjalë shumë të lehta, si p.sh. fjala fat, por ka edhe fjalë të bashkëngjitura, si p.sh. flokëthinjur.

2. *Testi individual për identifikimin e vështirësive në lexim*, mat shkathtësitë e nxënësve në:

- përpunimin fonologjik (heqja e rrokjeve, bashkimi i fonemave);
- njohuritë për shkronjat (njohja e shkronjave, emërtimi i shkronjave);
- lexim (leximi i fjalëve, leximi i pseudofjalëve);
- emërtimin e shpejtë serik.

Për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit u shërbyem edhe me pyetësorë. Pyetësorët i pilotuam me një mostër të nxënësve dhe të mësimdhënësve. Pyetësorët ishin të përshtatshëm dhe nuk kishte ndonjë nevojë për riformulim apo plotësim të tyre.

Pyetësoi për nxënësit përmban 17 pyetje, përmes së cilave mblodhëm të dhëna personale, të dhëna për shkollën, të dhëna për familjen, preferencat e tyre për shkrimin dhe leximin, kohën që i kushtojnë shkrimit dhe leximit, si dhe mbështetjen që iu ofrohet.

b) *Mbledhja e të dhënave nga mësimdhënësit* u bë me pyetësorë.

Për mbledhjen e të dhënave nga mësimdhënësit, u shërbyem me dy lloje të pyetësorëve, të cilët i përdorëm në dy faza të ndryshme:

- ❖ *Pyetësoi 1* - përmes të cilit mblodhëm të dhëna lidhur me praktikën e identifikimit të nxënësve me vështirësi në shkrim dhe në lexim, si dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit, me qëllim të tejkalimit të vështirësive.

Të dhënat që mblodhëm përmes pyetësorit ndahen në katër blloqe:

- Të dhëna të përgjithshme për mësimdhënësit, si: gjinia, mosha, përgatitja shkollore, përvoja e punës, niveli i shkollimit dhe numri i nxënësve me të cilët punon.
 - Të dhëna lidhur me identifikimin e nxënësve me vështirësi në shkrim dhe në lexim, si: numrin e nxënësve me vështirësi, mënyrën e identifikimit, llojet e vështirësive;
 - Të dhëna lidhur me ofrimin e mbështetjes për nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim, si: gatishmërinë e nxënësve për përfshirje në aktivitete plotësuese, për përmirësimin e shkathtësive në shkrim-lexim, përkrahjen e ofruar nga mësimdhënësi, shkolla, prindi etj.
 - Rekomandimet e mësimdhënësve për përmirësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim, si: praktikatat më të mira, ndryshimet që duhet bërë etj.
- ❖ *Pyetësori 2* - aplikohet pas ofrimit të mbështetjes për nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim, me qëllim të vlerësimit të punës/ mbështetjes së ofruar për nxënësit me vështirësi. Vlerëson ecurinë e punës me nxënës, pikat e forta dhe dobësitë e praktikës së përzgjedhur për mbështetjen e nxënësve, si dhe rekomandimet për ndryshime eventuale.

Pra, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët lidhen me punën e mësimdhënësve rreth identifikimit të nxënësve me vështirësi, planifikimit, organizimit dhe realizimit të punës me nxënësit e identifikuar me vështirësi në shkrim-lexim.

Procedurat e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat përmes instrumenteve të studimit i mbledhëm në objektin e shkollës, respektivisht në klasë. Meqë studimi kishte kohëzgjatje prej një viti shkollor, të dhënat nga pjesëmarrësit, nga mësimdhënësit dhe nga nxënësit, janë mbledhur në periudha të ndryshme kohore, në faza të ndryshme të projektit të studimit.

a) Mbledhja e të dhënave nga nxënësit

Mbledhja e të dhënave nga nxënësit u bë përmes testeve. Vlerësimet me teste u bënë në tri faza të ndryshme:

Vlerësimi i parë - u organizua me të gjithë nxënësit e klasave 3-5, në shkollat e përfshira në studim. Fillimisht me nxënësit u bë testimi grupor, me qëllim të identifikimit të nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim. Në këtë fazë nxënësit vlerësohen në shkrim dhe në lexim. Testi i leximit mat shkathtësitë e nxënësve në leximin me kuptim dhe rrjedhshmëri të leximit, ndërsa testi i shkrimit mat shkathtësitë e nxënësve në drejtshkrim.

Testimi i nxënësve u administrua nga ekipi hulumtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe mësimdhënësit e klasës përkatëse. Para fillimit të vlerësimit u bë parapërgatitja e nxënësve për testim, duke i përgatitur ata emocionalisht për testimin dhe duke iu ofruar informacione të mjaftueshme për testin.

Vlerësimi i parë që u realizua ishte vlerësimi i nxënësve në lexim. Koha e testimit në lexim ishte 3 minuta, nga koha kur nxënësi fillon të përgjigjet, duke mos llogaritur kohën e dhënies së udhëzimeve dhe përgatitjes së nxënësve për testim. Fillimisht, para vlerësimit, me nxënës u ushtruan 5 fjali të ngjashme, me qëllim që nxënësit të kenë të qarta udhëzimet. Brenda kohës së paraparë nxënësi përgjigjet në atë fjali sa mundet.

Pas përfundimit të testimit në lexim, pas një pushimi të shkurtër, nxënësit u vlerësuan edhe në shkrim. Vlerësimi në shkrim u bë në formë diktimi. Nxënësve iu diktuan 20 fjalë të niveleve të ndryshme të vështirësive. Administruesi lexon fjalët, ndërsa nxënësit i shkruajnë ato në fletëtestin e

tyre. Sipas rregullit të testimit, secila fjalë diktohet dy herë, ndërsa koha e përcaktuar është 20 sekonda për shkrimin e secilës fjalë.

Paraprakisht nxënësve u janë dhënë udhëzimet për mënyrën, kohën e plotësimit, dhe ecurinë e testimit.

Pas përfundimit i mbledhëm testet, bëmë një bisedë të shkurtër për mënyrën se si ata u ndien dhe sfidat që kishin gjatë testimit. Pastaj, nxënësve ua shpërndamë pyetëtorin, me anë të të cilit nga nxënësit mbledhëm të dhëna për nxënësin, të dhëna për kushtet familjare në të cilat jetojnë nxënësit, dhe mbështetjen që u ofrohet në shkollë.

Vlerësimi i dytë – u bë në formë individuale dhe u organizua vetëm për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate në vlerësimin e parë. Ky vlerësim u administrua nga mësimdhënësit e arsimit fillor/mësimdhënësit e shkollës. Paraprakisht, mësimdhënësit, përmes trajnimit dyditor, i përgatitëm për testimin e nxënësve, identifikimin e vështirësive dhe ofrimin e mbështetjes pas identifikimit.

Vlerësimi bëhet në një klasë/kabinet të qetë, ku prezent janë vetëm mësimdhënësi dhe nxënësi i testuar. Testuesi ka dy përgjegjësi kryesore gjatë testimit: të ndjekë udhëzimet e udhëzuesit të përdoruesve të testit dhe të ofrojë mundësi për nxënësin të punojë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Vlerësimi i tretë – pas analizës së rezultateve të vlerësimit individual, u bë identifikimi i vështirësive të nxënësve dhe nxënësit e identifikuar u grupuan sipas vështirësive që kanë. Pas kësaj, në shkollë u bë plani i veprimtimit dhe filloi puna me grupet e nxënësve me vështirësi. Ndërsa, pas përfundimit të punës plotësuese me nxënësin, në përfundim të vitit shkollor, u organizua edhe vlerësimi i tretë, i cili kishte për qëllim edhe vlerësimin e ndikimit të mbështetjes së ofruar për nxënësin dhe u realizua pas përfundimit të punës plotësuese me nxënësit e identifikuar me vështirësi.

Vlerësimi i tretë është organizuar me testin dhe kriteret e vlerësimit të parë, me qëllim të analizës dhe krahasimit të rezultateve. Testimi është administruar nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik, në bashkëpunim me mësimdhënësit e shkollës.

b) Mbledhja e të dhënave nga mësimdhënësit

Të dhënat nga mësimdhënësit i kemi mbledhur me pyetësorë. Administrimi i pyetësorëve në shkollë u bë nga hulumtuesit e IPK-së. Të gjithë mësimdhënësit e arsimit fillor u mblodhën bashkë në një sallë dhe në të njëjtën kohë u përgjigjën në pyetësorë.

Pyetësori i parë u aplikua në të njëjtën ditë kur u realizua testimi i parë me nxënës, ndërsa pyetësori i dytë u aplikua pas realizimit të aktiviteteve plotësuese me nxënësit me vështirësi në shkrim dhe në lexim, në të njëjtën ditë kur u bë edhe testimi i nxënësve që mat efektin e punës plotësuese me nxënës.

Të dhënat e mbledhura i vendosëm në bazën e të dhënave, në programin SPSS, dhe i përpunuam me të njëjtin program.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e mbledhura janë informata faktike, të mbledhura përmes instrumenteve vlerësuese dhe perceptime të mësimdhënësve. Meqenëse qasja jonë është e përzier, sasiore dhe cilësore, analizën e të dhënave të mbledhura e bëmë në dy mënyra:

1. Përmes programit kompjuterik SPSS (Statistical Package for the Social Science - pakoja Statistikore për Shkencat Shoqërore);
2. Përmes metodës së kategorizimit, duke grupuar së bashku komentet mbi tema të ngjashme.

Të dhënat e mbledhura nga nxënësit janë analizuar ndaras për secilin nxënë, secilën paralele dhe secilën shkollë. Pas testimit të parë, u bënë kontrollimi dhe vlerësimi i testeve vlerësuese. Për secilën përgjigje të drejtë, nxënësi vlerësohet me pikë, ndërsa shpejtësia e leximit është matur me kohën e leximit. Vlerësimi i testeve u bë me shkallën e vlerësimit, që është paraparë nga ekspertët që kanë përgatitur testet.

Të dhënat e mësimdhënësve janë të përziera. Të dhënat faktike, si: gjinia, mosha, përgatitja shkollore, përvoja e punës etj., i analizuam përmes analizës së programit SPSS, ndërsa për analizën e të dhënave cilësore, mendimeve të mësimdhënësve të shprehura në pyetjet e hapura, bëmë përshkrimin dhe interpretimin sipas kategorive tematike që lidhen me pyetjet kërkimore.

Etika - Testet e nxënësve ruhen në konfidencialitet të lartë. Qasje në testet dhe rezultatet e nxënësve kanë vetëm personat kompetentë në Institutin Pedagogjik të Kosovës, ndërsa informacion mund të kenë edhe shkollat për nxënësit e tyre, prindërit për fëmijët e tyre, dhe mësimdhënësit e klasave.

REZULTATET E STUDIMIT

Rezultatet e dala nga vlerësimi i nxënësve në shkrim-lexim mundësuan identifikimin e vështirësive të tyre në shkrim dhe në lexim. Në vazhdim prezantojmë rezultatet e dala nga studimi, për pjesëmarrësit në studim.

Për nxënësit prezantojmë të dhëna demografike, të dhëna nga vlerësimet e nxënësve në shkrim-lexim, si dhe të dhëna për mbështetjen e ofruar në tejkalimin e vështirësive të tyre në shkrim-lexim.

Për mësimdhënësit e përfshirë në studim do të prezantojmë po ashtu të dhëna demografike, si dhe të dhëna për mbështetjen e ofruar për ta, me qëllim të përkrahjes së mësimdhënësve në ofrimin e ndihmës për nxënës, për tejkalimin e vështirësive në shkrim-lexim.

Të dhëna demografike të pjesëmarrësve në studim

Në studim kanë marrë pjesë nxënësit e dhjetë shkollave, nga tri komuna: Malishevë N=250, Drenas N=229 dhe Hani i Elezit N=455. Edhe mësimdhënësit vijnë po nga të njëjtat shkolla dhe nga të njëjtat komuna, nga komuna e Malishevës N=46 ose 44,7%, nga komuna e Drenasit N=20 ose 19.4, ndërsa nga komuna e Hanit të Elezit N= 37 ose 35.9%.

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat e pjesëmarrësve në studim, nxënës dhe mësimdhënësve, të specifikuar për secilën shkollë.

Tabela 11. Të dhëna demografike për pjesëmarrësit e përfshirë në studim

Shkolla	Nxënës						Mësimdhënës					
	Meshkuj		Femra		Gjithsej		Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	67	7.1	42	4.5	109	11.6	3	2.9	4	3.9	28	27.0
2	20	2.1	22	2.3	42	4.5	6	5.8	5	4.9	11	10.7
3	36	3.8	35	3.7	71	7.6	4	3.9	3	2.9	7	6.8
4	17	1.8	16	1.7	33	3.5	12	11.7	16	15.3	7	6.8
5	26	2.8	33	3.5	59	6.3	3	2.9	1	1.0	4	3.9
6	200	21.3	169	17.2	362	38.5	12	11.7	12	11.7	24	23.4
7	22	2.3	13	1.4	35	3.7	1	1.0	4	3.9	5	4.9
8	40	4.3	33	3.5	73	7.8	6	5.8	1	1.0	7	6.8
9	38	4.0	38	4.0	76	8.0	2	1.9	3	2.9	5	4.8
10	49	5.3	31	3.3	80	8.5	4	3.9	1	1.0	5	4.9
Gjithsej	515	54.8	425	45.2	940	100	53	51.5	50	48.5	103	100

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën numër 1, shohim se gjithsej në studim janë përfshirë 940 nxënës, prej tyre N=515 ose 54.8% janë meshkuj, ndërsa N=425 ose 45.2% janë femra. Nxënësit janë të moshës 7-11-vjeçare, të cilët vijojnë mësimet në shkollën e dytë të arsimit fillor. Prej tyre, N=325 apo 34.6% janë nxënës të klasës së tretë, N=295 ose 31.4% janë nxënës nga klasa e katërt, ndërsa N=320 ose 34.0% janë nxënës të klasës së pestë.

Ndërsa, mësimdhënësit e përfshirë në studim janë mësimdhënës të arsimit fillor, të cilët punojnë me nxënësit e klasës së parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë. Nga 103 mësimdhënësit e përfshirë në studim, N=53 ose 51.5% janë meshkuj, ndërsa 50 ose 48.5% janë femra.

Vlerësimi i nxënësve

Me qëllim të matjes së shkathtësive dhe identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim, për nxënësit e përfshirë në studim kemi organizuar tri vlerësime. Vlerësimi i parë u organizua me qëllim të matjes së shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim. Me nxënësit, të cilët nuk treguan rezultate në vlerësimin e parë, u organizua vlerësimi i dytë, ndërsa vlerësimi i tretë u bë në fund të vitit shkollor, pas mbështetjes së ofruar, me qëllim që të matim efektet e mbështetjes së ofruar për nxënës.

Rezultatet nga vlerësimi i parë

Vlerësimi i parë në shkollat e përfshira në studim u organizua me të gjithë nxënësit e shkallës së dytë, të nivelit fillor, pra u përfshinë të gjithë nxënësit e klasës së tretë, nxënësit e klasës së katërt dhe nxënësit e klasës së pestë. Vlerësimi i parë u organizua në fillim të vitit shkollor, përkatësisht në muajin tetor.

Në vlerësimin e parë u përfshinë 940 nxënës. Vlerësimi u bë me anë të dy testeve, testit të shkrimit dhe testit të leximit. Kjo mundësoi që të matim njohuritë e nxënësve në lexim dhe në shkrim.

Tabela 12. Rezultatet e nxënësve në vlerësimin e parë

Komuna	Nxënës të vlerësuar		Nxënës që nuk kanë treguar rezultate në shkrim		Nxënës që nuk kanë treguar rezultate në lexim		Nxënës që nuk kanë treguar rezultate në shkrim dhe në lexim		Gjithsej me rezultate nën mesataren e pritur	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	229	100	56	6.0	13	1.4	54	5.7	123	13.08
2	255	100	75	8.0	18	1.9	79	8.4	172	18.30
3	456	100	101	10.7	23	2.4	90	9.6	214	22.77
Gjithsej	940	100	232	24.7	54	5.7	223	23.7	509	54.15

Rezultatet e vlerësimit të parë tregojnë se 54.15% e nxënësve të vlerësuar ishin nën mesataren e pritur. Prej tyre, N= 232 ose 24.7% vetëm në shkrim, N=54 ose 5.7% vetëm në lexim, ndërsa N=223 ose 23.7% nuk arritën mesataren e pikëve në të dyja vlerësimet e bëra, në shkrim dhe në lexim.

Vlerësimi në shkrim u bë në formë të diktimit dhe u përfshinë 20 fjalë me nivele të ndryshme të vështirësisë. Maksimumi i pikëve të mundshme ishte 20 pikë (1 pikë për secilën fjalë), ndërsa mesatarja e pritur ishte 10 pikë.

Rezultatet e nxënësve në vlerësimin e parë, siç edhe shihet nga tabela nr. 13, nuk ishin të kënaqshme.

Tabela 13. Rezultatet e nxënësve sipas pikëve të marra në vlerësimin e parë në shkrim

Arritjet e nxënësve	Nën mesataren e pritur	Mbi mesataren e pritur	Gjithsej
Numri i nxënësve	455	485	940
%	48.4	51.6	100

Rezultatet e nxënësve në vlerësimin e parë në shkrim ishin nga 0-20 pikë, ndërsa mesatarja e pikëve të nxënësve ishte $M=7$ ($Min=0$, $max=20$, $M=7.16$, $Dvs. 4.008$).


Vlerësimi në lexim u bë me anë të testit të leximit. Nxënësit kishin detyrë të lexonin fjali dhe të jepnin përgjigjen e drejtë, nëse fjalia është e saktë apo e gabuar. Rezultatet e vlerësimit të parë tregojnë se N= 277 ose 29.47% e nxënësve të përfshirë në vlerësim nuk kanë arritur mesataren e mundshme të pikëve në testin vlerësues të leximit. Prej tyre, N=54 ose 5.7% nuk kanë arritur rezultate vetëm në vlerësimin e leximit, ndërsa N=223 ose 23.7 % e nxënësve të vlerësuar janë treguar të pasuksesshëm

në të dyja vlerësimet, në shkrim dhe në lexim. Minimumi i pikëve në lexim ishte 0, maksimumi ishte 67, nga 70 pikët e mundshme, ndërsa mesatarja ishte 21.76 ($Ma=21.74$, $Dvs=12.902$).

Megjithëkëtë, rezultatet e studimit tregojnë dallime të dukshme ndërmjet rezultateve të nxënësve në lexim dhe rezultateve të nxënësve në shkrim (*Lexim: min=0, max=67, M=21.74, V=166.449, ndërsa në shkrim: min=0, max=20, Ma=7.16, V=16.051*).

Rezultatet e nxënësve në shkrim janë dukshëm më të ulëta se rezultatet në lexim. Sa u përket dallimeve të nxënësve, del se nxënësit e klasës së pestë, në të dyja vlerësimet, kanë treguar rezultate më të ulëta, krahasuar me nxënësit e klasës së katërt dhe nxënësit e klasës së tretë.

Rezultate më të larta në të dyja vlerësimet kanë treguar nxënësit e klasës së tretë.



Grafiku 2. Dallimi mes rezultateve të nxënësve në lexim dhe shkrim

Në vlerësimin e parë, **nga klasa e tretë** gjithsej kanë marrë pjesë 325 nxënës, prej tyre $N=175$ ose 53.8% ishin djem, ndërsa $N=150$ ose 46.2% ishin vajza.

Të dhënat tregojnë se N=94 ose 28.9% e nxënësve të klasës së tretë nuk kanë treguar rezultate në vlerësimin e shkrimit dhe vlerësimin e leximit.

Tabela 14. Nxënësit e klasës së tretë me rezultate nën mesatare në lexim dhe shkrim në vlerësimin e parë

Vetëm në lexim		Vetëm në shkrim		Lexim dhe shkrim		Gjithsej	
Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
28	8.6	38	11.7	28	8.6	94	28.9

Rezultatet tregojnë dallime ndërmjet nxënësve në vlerësimin e parë në lexim ($min=0$, $max=58$, $M=14.23$, $va=8.861$), ashtu edhe në vlerësimin e parë në shkrim ($min=0$, $max=19$, $M=6.71$, $Va=3.947$). Rezultatet e studimit tregojnë se nxënësit e klasës së tretë janë më të mirë në lexim sesa në shkrim, por që nuk është ndonjë dallim i madh (dallimi është vetëm 3,1%).

Sa i përket gjinisë së nxënësve, nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor në raport me rezultatet e tyre në shkrim-lexim. Dallime të vogla mes nxënësve të komunave të ndryshme vërehen në rezultatet e nxënësve në shkrim, pasi mesatarja e tyre varion nga 5.41 në 8.09 ($K1/M=8.09$, $K2/M=5.41$, $K3/M=6.67$ - ku $K1$, $K2$ dhe $K3$ paraqesin e shkurtesat për komunat).

Nga **klasa e katërt**, në vlerësimin e parë gjithsej janë përfshirë 295 nxënës. Prej tyre, N=160 ose 54.2% djem dhe N=135 ose 45.8% vajza, ndërsa moshja e tyre sillet nga 7-10 vjeç, kurse moshja mesatare është 9 vjeç.

Rezultatet e studimit tregojnë se N=152 ose 51.53% e nxënësve të klasës së katërt nuk janë treguar të suksesshëm në vlerësimin e shkrimit dhe vlerësimin e leximit.

Tabela 15. Të dhëna nga nxënësit e klasës së katërt, të cilët nuk u treguan të suksesshëm në vlerësimin e parë

Vetëm në lexim		Vetëm në shkrim		Lexim dhe shkrim		Gjithsej	
Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
13	4.1	70	23.7	69	23.4	152	51.53

Të dhënat nga tabela numër 15 tregojnë se numri më i madh i nxënësve të klasës së katërt në vlerësimin e parë rezultate më të ulëta kanë treguar në shkrim. Mesatarja e pikëve në vlerësimin në shkrim ishte $M=7.32$, ndërsa në lexim ishte $M=23.69$.

Tabela 16. Të dhëna përshkruese për rezultatet e nxënësve të klasës së katërt në vlerësimin e parë

	N	Min	Max	Mesatarja	DS
Rezultatet në lexim	295	0	61	23,69	12,246
Rezultatet në shkrim	295	0	18	7,32	3,873

Sa i përket gjinisë, rezultatet nuk tregojnë dallime ndërmjet djemve dhe vajzave në raport me shkrimin dhe leximin. Djemtë dhe vajzat treguan rezultate afërsisht të njëjta në vlerësimin e shkrim-leximit. Dallime vërehen te grupi i nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim, ku prej numrit të përgjithshëm të nxënësve të klasës së katërt me vështirësi $N=69$, prej tyre $N=40$ ose 58% janë djem, ndërsa $N=29$ ose 42% janë vajza.

Nga nxënësit *e klasës së pestë*, të cilët kanë marrë pjesë në vlerësim $N=320$ nxënës, prej tyre $N=180$ ose 56.2% ishin djem, ndërsa $N=140$ ose 43.8% ishin vajza. Moshë e tyre sillet nga 10-13 vjeç, ndërsa moshë mesatare e nxënësve të klasës së pestë, të cilët ishin të përfshirë në studim është 12 vjet. Rezultatet e dala nga vlerësimi tregojnë se $N=263$ ose

82.19% e nxënësve të klasës së pestë, të cilët kanë marrë pjesë në studim, nuk kanë treguar rezultate të mira në vlerësimin e parë.

Tabela 17. Nxënësit e klasës së pestë, të cilët nuk u treguan të suksesshëm në vlerësimin e parë

Lexim		Shkrim		Lexim/shkrim		Gjithsej	
Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
13	4.1	124	38.8	126	39.37	263	82.19

Në tabelën numër 17 shohim se një numër i konsiderueshëm i nxënësve të klasës së pestë janë treguar të pasuksesshëm në të dyja vlerësimet, e nëse i analizojmë të dyja del se numri i nxënësve që kanë treguar rezultate të ulëta në vlerësimin e shkrimit është shumë më i madh se numri i nxënësve që kanë treguar rezultate të ulëta në vlerësimin e leximit.

Mesatarja e pikëve në vlerësimin e shkrimit te nxënësit e klasës së pestë është $M=7.43$, ndërsa në lexim 27.29 .

Tabela 18. Të dhëna përshkruese për rezultatet e nxënësve të klasës së pestë në vlerësimin e parë

	N	Min	Max	Mesatarja	DS
Rezultatet në lexim	320	0	68	27,59	13,293
Rezultatet në shkrim	320	0	20	7,43	4,158

Në vlerësimin e parë, shumica e nxënësve të klasës së pestë ishin më të dobët në shkrim. Por, numri i nxënësve, të cilët nuk arritën rezultatet e pritura në të dyja vlerësimet, në shkrim dhe në lexim, ishte mjaft i madh, $N=126$ ose 39.37 , e që shumica prej tyre ishin djem, ndërsa nuk kishte dallime të theksuara sa i përket gjinisë te nxënësit, të cilët kishin rezultate të ulëta vetëm në lexim.

Vështirësitë e nxënësve - llojet e vështirësive

Për të identifikuar nxënësit me vështirësi dhe llojet e vështirësive, me të cilat ballafaqohen nxënësit, realizuam vlerësimin e dytë. Në vlerësimin e dytë morën pjesë të gjithë nxënësit, të cilët nuk arritën mesataren e pritur në shkrim-lexim në vlerësimin e parë.

Gjithsej në vlerësimin e dytë u përfshinë N=495 nxënës, ku prej tyre N=287 ose 58% ishin djem, ndërsa N=208 ose 42% ishin vajza, ndërsa sa i përket klasës, N=104 ose 22.0% janë nxënës të klasës së tretë, N=134 ose 28.3% janë nxënës të klasës së katërt dhe N=235 ose 49.7% janë nxënës të klasës së pestë.

Në tabelën numër 19 janë paraqitur të dhëna për klasën, komunën dhe gjininë e nxënësve të përfshirë në vlerësimin e dytë.

Tabela 19. Të dhëna për nxënësit e përfshirë në vlerësimin e dytë

Komuna	Klasa						Gjinia				Gjithsej	
	E tretë		E katërt		E pestë		Djem		Vajza			
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	32	15.7	76	37.3	96	47.1	116	42.0	88	44.7	204	43.1
2	30	28.6	18	17.1	57	54.3	66	23.9	39	19.8	105	22.2
3	42	25.6	40	24.4	82	50.0	94	34.1	70	35.5	164	34.7
Gjithsej	104	100	134	100	235	100	276	100	197	100	495	100

Nga të dhënat shohim se numri më i madh i nxënësve, të cilët janë përfshirë në vlerësimin e dytë, janë nxënës të klasës së pestë N=235 ose 49.7%, pastaj të klasës së katërt N=134 ose 28.3% dhe të klasës së tretë N=104 ose 22.0%.

Vlerësimi i dytë u organizua me nxënësit, të cilët në vlerësimin e parë dolën nën mesataren e pritur, u realizua në formë individuale, për secilin nxënës. Instrumenti vlerësues përbëhej prej katër fushave, të cilat matin drejtpërdrejt shkathtësitë e leximit dhe të shkrimit:

1. Njohuritë për shkronjat

- 1.1. Njohja e shkronjave
- 1.2. Emërtimi i shkronjave

2. Përpunimi fonologjik

- 2.1. Bashkimi i fonemave
- 2.2. Heqja e rrokjeve

3. Leximi

- 3.1. Leximi i fjalëve
- 3.2. Leximi i fjalive

4. Shkrimi

- 4.1. Shkrimi i shkronjave
- 4.2. Shkrimi i fjalëve - diktim
- 4.3. Shkrimi i fjalive – diktim

Ky vlerësim nxori në pah vështirësi të ndryshme, me të cilat ballafaqohen nxënësit në shkrim-lexim. Nga nxënësit e përfshirë në vlerësimin e dytë, del se N=445 ose 90% prej tyre u identifikuan me vështirësi në fusha të ndryshme. Vështirësitë e tyre fillojnë që nga njohja dhe emërtimi i shkronjave.

Njohja dhe emërtimi i shkronjave

Nga nxënësit e përfshirë në vlerësimin e dytë të identifikuar me vështirësi, N=77 ose 17.30% kanë vështirësi në njohjen dhe emërtimin e shkronjave, pasi prej tyre N=26 ose 5.84% nuk i njohin shkronjat, N=9 ose 2.02% i njohin shkronjat, por kanë vështirësi në emërtimin e tyre, ndërsa N=42

ose 9.44% e nxënësve nuk i njohin dhe nuk janë në gjendje t'i emërtojnë të gjitha shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në studim, të cilët nuk i njohin të gjitha shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe, N=8 ose 1.62% janë nxënës të klasës së tretë, (7.68 % e nxënësve të klasës së tretë), N=7 ose 1.41 janë nxënës të klasës së katërt (5.28% e nxënësve të klasës së katërt), ndërsa N=11 ose 2.22% janë nxënës të klasës së pestë (4.68% e nxënësve të klasës së pestë). Këta nxënës nuk i njohin shkronjat nëse e pyet se cila është shkronja e caktuar në mesin e shkronjave tjera, përkundër se i shohin ato, por janë në gjendje t'i emërtojnë shkronjat nëse i vendos shkronjat një nga një para tij.

Nga nxënësit, të cilët nuk janë në gjendje t'i emërtojnë të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, N=2 ose 0.40 janë nxënës të klasës së tretë, N=4 ose 0.81% janë nxënës të klasës së katërt, ndërsa N=3 ose 0.61% janë nxënës të klasës së pestë. Këta nxënës përkundër që i njohin shkronjat, kanë vështirësi dhe u nevojitet ndihmë kur është e nevojshme t'i emërtojnë ato.

Ndërsa, N=42 ose 4.44% e nxënësve të përfshirë në vlerësimin e dytë nuk i njohin e as nuk janë në gjendje t'i emërtojnë ato, pra kanë vështirësi edhe në njohjen edhe emërtimin e shkronjave, ku prej tyre N=20 ose 2.12% janë nxënës të klasës së tretë, N=10 ose 1.06 % janë nxënës të klasës së katërt, ndërsa N=12 ose 1.27% janë nxënës të klasës së pestë.

Vështirësitë në shkrim


Të dhënat nga vlerësimi i nxënësve tregojnë se vështirësitë e tyre nuk lidhen vetëm me njohjen dhe emërtimin e shkronjave. Nga rezultatet e vlerësimit, del se nxënësit e përfshirë në vlerësimin e dytë, prej tyre N=368 ose 74.34% i njohin dhe i emërtojnë shkronjat. Megjithëkëtë, N=145 ose 29.3%, edhe pse i njohin shkronjat, kanë vështirësi në shkrim, N=58 ose 11.7% kanë vështirësi në lexim, ndërsa N=165 ose 33.3% kanë vështirësi në shkrim dhe në lexim.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve, të cilët kanë vështirësi në shkrim (N=145), prej tyre N=21 ose 14.48% shkruajnë tepër ngadalë dhe e kanë të pamundur të realizojnë detyrën/ shkrimin që kërkohet nga ata brenda një kohe të caktuar, e që N=8 ose 5.52% prej tyre as që e filluan detyrën, ndërsa N=13 ose 8.97% filluan dhe mbetën pa e përfunduar fjalën e parë.

Vështirësitë e nxënësve në shkrim kryesisht lidhen me drejtshkrimin. N=124 ose 27.87 % e nxënësve të përfshirë në studim, edhe pse i njohin dhe i shkruajnë shkronjat, kanë vështirësi të theksuara në drejtshkrim, ku prej tyre N=12 ose 9.68% shkruajnë fjalët pa kuptim, fjalë të cilat jo veçse nuk janë diktuar, por nuk kanë as domethënie në gjuhën shqipe, p.sh. në vend të fjalës lapsi shkruan fjalët lati, lasi, lai, në vend të fjalës ëmbëlsirë, shkruan ëmblsir, në vend të fjalës histori, shkruan histri etj.

Nga nxënësit, të cilët rezultuan me gabime drejtshkrimore, prej tyre N=23 ose 18.55% i lënë fjalët në gjysmë, N=18 ose 14.51% ngatërrojnë shkronjat, sidomos bashkëtingëlloret, si: b me d, r me l, dh me ll, xh me gj, zh me sh, ndërsa N=13 ose 10.48% i “hanë” shkronjat brenda apo në fund të fjalës.

Ja si shkruhet fjala fëmija nga nxënës të ndryshëm:



Fjala e paraqitur është shkruar në forma të ndryshme, nga nxënës të ndryshëm, edhe pse njëjtë është diktuar për të gjithë, d.m.th. është diktuar në të njëjtën kohë, njësoj për fëmijët e së njëjtës paralele/klasë.

Një numër i nxënësve, N=17 ose 13.71% kanë vështirësi në shkrimin e fjalëve të gjata, të cilat përbëhen me më tepër se 6 shkronja, p.sh. aeroplan, nga 29 nxënës nga një paralele e klasës së pestë, vetëm 4 prej tyre fjalën aeroplan e kanë shkruar drejt, pa gabime. Kjo fjalë nga nxënësit e kësaj paraleleje të klasës së pestë është shkruar në dhjetë versione të ndryshme, si: ajroplan (12 nxënës), Airoplan (4 nxënës), arjoplan dhe aroplan (nga 3 nxënës), ndërsa areplan, aeoplan dhe ajorplan (nga 1 nxënës).

Shkrimi i fjalëve të bashkëlidhura po ashtu duket problematik te një pjesë e nxënësve të përfshirë në vlerësim. Nga gjashtë fjalë të bashkëlidhura, sa përmbante testi vlerësues, N= 18 ose 14.52% e nxënësve nuk arritën t'i shkruajnë ato. Disa prej nxënësve që arritën t'i shkruajnë fjalët e bashkëlidhura i ndanë ato në dy apo tri pjesë, varësisht se si tingëllonin, si dy apo tri fjalë, p.sh.: atdhe dashës, flokë thinjur, drejt për drejt etj.

N=23 ose 18.55% kanë vështirësi në përdorimin e shkronjës ë, qoftë si shkelje e normës drejtshkrimore, p.sh. në vend të fjalës fëmijë shkruan fëmij, apo në vend të fjalës ëmbëlsirë shkruan ëmbëlsir; qoftë si shkelje e normës së natyrës fonologjike, si p.sh. në vend të fjalës flokëthinjur shkruan flokthinjur, në vend se të shkruajë drejtpërdrejt, nxënësi shkruan drejtperdrejt, etj.

Edhe mësimdhënësit nuk e mohojnë se kanë nxënës me vështirësi në shkrim, pasi 71,1% e mësimdhënësve të përfshirë në studim pohojnë se në klasat e tyre ka nxënës me vështirësi në shkrim. Sipas mësimdhënësve, vështirësitë e nxënësve në shkrim kanë të bëjnë me njohjen e shkronjave, shkrimin e tyre, formimin e fjalëve, shkrimin me kuptim.

Ata pranojnë se në klasat e tyre ka nxënës që nuk i mbajnë mend shkronjat, qoftë në formën e shkruar apo në shqiptimin e tyre dhe i ngatërrojnë shkronjat që duken të ngjashme në shqiptim apo pamje, si b-d, p-q, m-n, p-b etj. Shumica e nxënësve që kanë vështirësi në shkrim, sipas

mësimdhënësve, kanë vështirësi në formimin e fjalëve, vështirë i lidhin shkronjat në një fjalë, ua ndërrojnë vendet shkronjave, nuk i shkruajnë të gjitha shkronjat, shkruajnë shkronja tepër në fund të fjalës etj.

Vështirësitë në lexim

Vlerësimi i dytë nxori në pah edhe vështirësitë e nxënësve në lexim. Nga N=445 ose 90% prej tyre u identifikuan në vështirësi, prej tyre N=300 ose 67.42% kanë të bëjnë me vështirësi në lexim.

Nga numri i nxënësve, të cilët u identifikuan me vështirësi në lexim, shumica prej tyre kanë vështirësi edhe në shkrim N=165 ose 55%, vështirësi në njohjen dhe emërtimin e shkronjave N=77 ose 25.67, ndërsa vetëm N=58 ose 8.45% nga nxënësit e përfshirë në vlerësimin e dytë kanë vështirësi vetëm në lexim. Tabela në vijim përmban të dhëna të nxënësve që në vlerësimin e dytë u identifikuan me vështirësi vetëm në lexim.

Tabela 20. Rezultatet e nxënësve në lexim, të dala nga vlerësimi i dytë

Lloji i vështirësisë	Nxënësit		Gjinia	
	Nr	%	M	F
Leximi dhe shkrimi i rrokjeve	17	29.31	9	8
Shpejtësia e leximit	8	13.79	3	5
Leximi i fjalëve	33	56.90	19	14
Gjithsej	58	100	31	27

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 20, shohim se shumica e nxënësve kanë vështirësi në leximin e fjalëve dhe vështirësitë e shumta në leximin e fjalëve i hasim në fjalët e gjata (N=12 ose 26%), vështirësi në leximin e fjalëve të bashkëlidhura (N=16 ose 48%), si dhe vështirësi në leximin e fjalëve që nxënësi i has për herë të parë, ose fjalëve që nuk ia di kuptimin. Sa u përket leximit dhe shkrimit me rrokje, nxënësit shkruajnë ose lexojnë më me vështirësi rrokjet që në përbërjen e tyre kanë edhe shkronja dyshe.

Shumica nga nxënësit që kanë vështirësi në leximin e rrokjeve, lexojnë me shkronja, lexojnë shkronjë për shkronjë, por kanë vështirësi t'i lidhin bashkë dhe të lexojnë rrokje.

Gjatë vlerësimit, u identifikuan edhe nxënës që lexojnë përmendësh, e si pasojë e kësaj ata nuk i lexojnë drejt fjalët kur paraqiten në trajta të ndryshme, p.sh. fjalën “molla” e lexojnë gjithherë si “molla”, edhe kur ka raste se në tekst është e shkruar “mollë”, “mollës”, “mollët” etj.

Te nxënësit e vlerësuar u vërejt edhe problemi me zëvendësimin e zanoreve, p.sh. në vend të “a” lexon “u” fjalën “ku” e lexon “ka”, në vend të “la” e lexon “lu”. Pastaj, në disa raste u vërejt edhe lëshimi ose shtimi i tingujve gjatë leximit, kur nxënësi harron ose lëshon tinguj, p.sh. në vend të fjalës “nora” lexon “noa” ose “ora”, apo në vend të fjalës “noa” lexon “nora”, apo zëvendësimi i tingujve të ngjashëm, si b-p, k-g, përsëritja e rrokjes së fundit dy herë, kapërcimi i fjalëve ose rreshtave, kur nxënësi kalon fjalë gjatë leximit, ose kapërcen rreshtat, përsërit disa herë të njëjtën fjalë, apo vazhdon leximin e të njëjtit rresht, e që duket si mungesë e vëmendjes dhe përqendrimit gjatë leximit.

Te nxënësit me vështirësi në lexim ishin të pranishme edhe vështirësitë që lidhen me shpejtësinë në lexim dhe vështirësinë e teksteve. Tekstet më të vështira në lexim u vërejt se ndikojnë në shpejtësinë dhe në saktësinë e leximit.

Krahasimi i rezultateve të nxënësve

Studimi nuk vë në pah dallime të mëdha ndërmjet nxënësve në aspektin e vështirësive në shkrim-lexim. Sa i përket gjinisë, nuk ka dallime të theksuara në rezultatet e nxënësve. Përqindja e vajzave me vështirësi në shkrim është e përafërt me përqindjen e meshkujve, pasi 53% e nxënësve me vështirësi në shkrim janë femra, ndërsa 47% janë meshkuj, dallim është vetëm 6%. Ndërsa, sa u përket vështirësive në lexim, përqindja është pothuajse e njëjtë, dallon vetëm gjinia, pasi 53.45 % e nxënësve me vështirësi në lexim janë meshkuj, ndërsa 46.55% janë femra, dallimi është 6.9%.

Sa i përket klasës, vërehet një dallim i dukshëm ndërmjet nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim në klasa të ndryshme. Numri më i madh i nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim janë identifikuar në klasën e pestë. Tabela numër 21 tregon nxënësit me vështirësi në shkrim dhe në lexim sipas klasave.

Tabela 21. Nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim sipas klasave

Lloji i vështirësisë	E tretë		E katërt		E pestë		Gjithsej	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Njohja e shkronjave	8	9.30	7	8.33	11	6.87	26	7.88
Emërtimi i shkronjave	2	2.32	4	4.77	3	1.87	9	2.73
Njohja dhe emërtimi i shkronjave	20	23.26	10	11.90	12	7.5	42	12.72
Lexim	29	33.72	12	14.29	17	10.63	58	17.58
Shkrim	14	16.28	41	48.81	90	56.25	145	43.94
Lexim dhe shkrim	13	15.12	10	11.90	27	16.88	50	15.15
Gjithsej	86	100.0	84	100.0	160	100	330	100.0

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se nga numri i përgjithshëm i nxënësve të identifikuar me vështirësi, numri më i madh i tyre janë nxënës të klasës së pestë. Ndërsa, sa u përket llojeve të vështirësive, ka dallime të nxënësit e klasave të ndryshme. Sipas të dhënave, nxënësit e klasës së tretë

në përqindje më të madhe kanë vështirësi në njohjen dhe emërtimin e shkronjave dhe në lexim, krahasuar me nxënësit e klasës së katërt dhe nxënësit e klasës së pestë. Nxënësit e klasës së katërt, me një përqindje pak më të lartë se nxënësit e klasës së tretë dhe të pestë, dallohen me vështirësitë e tyre në emërtimin e shkronjave, ndërsa nxënësit e klasës së pestë, krahasuar me nxënësit e klasës së tretë dhe të katërt, në përqindje më të madhe duket se kanë vështirësi në njohjen e shkronjave dhe shkrim-lexim.

Të dhënat e mbledhura nga pyetësi me nxënës tregojnë se nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim jetojnë me prindër, vëllezër dhe motra. 93.4% e nxënësve me vështirësi jetojnë me të dy prindërit, bashkë me vëllezër dhe motra, dhe 70% e nxënësve kanë dy e më shumë vëllezër apo motra. Sa i përket renditjes së fëmijës në familje, të dhënat e studimit tregojnë se fëmijët e mëdhenj kanë më shumë vështirësi në shkrim sesa fëmijët më të vegjël në familje. Nga të dhënat rezulton se 30.6% e nxënësve me vështirësi janë fëmijët më të mëdhenj në familje, fëmija i dytë 28.2%, fëmija i tretë 22.4%....., më i vogli 7.1%.

Tabela 22. Të dhëna përshkruese për fëmijët me vështirësi dhe radhën e fëmijëve në familje

	Min	Max	Mesatarja	Dv.s
Numri i fëmijëve në familje	1	6	2,62	1.45

Tabela pasqyron të dhëna përshkruese për fëmijët me vështirësi dhe numrin e fëmijëve në familje. Nga të dhënat shohim se numri i fëmijëve në familjet e nxënësve me vështirësi është 1-6, ndërsa mesatarja e fëmijëve në familjet e nxënësve me vështirësi është 3.

Suksesi i nxënësve ka rol në përvetësimin e shkathtësive të shkrim-leximit.

Tabela numër 23 pasqyron suksesin e nxënësve dhe llojet e vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim. Rezultatet e studimit tregojnë se, pavarësisht suksesit që kanë nxënësit, ata mund të përballen me vështirësi të ndryshme në shkrim-lexim, mirëpo dallojnë niveli dhe lloji i vështirësisë.

Tabela 23. Sukseset e nxënësve dhe llojet e vështirësive në shkrim

Suksesi	Lloji i vështirësive
Pamjaftueshëm	Njohja e shkronjave
Mjaftueshëm	Formimin/leximin e fjalëve; shkrim/lexim pa kuptim; shkrimin/leximin e fjalëve të gjata; përdorimin e shkronjës ë
Mirë	Fjalët në gjysmë; formimin/leximin e fjalëve; shkrimin/leximin e fjalëve të gjata; përdorimin e shkronjës ë
Shumë mirë	Përdorimin e shkronjës ë; radhitjen e shkronjave; ngatërrimin e shkronjave; shkrimin e shkronjave të bashkëlidhura; shkrimin/leximin e fjalëve të gjata,
Shkëlqyeshëm	Përdorimin e shkronjës ë; shkrimin/leximin e fjalëve të gjata

Të dhënat e paraqitura në tabelën 22 tregojnë se nxënësit, pavarësisht suksesit të tyre, mund të përballen me vështirësi në shkrim. Sa më i ulët të jetë suksesti i nxënësve, vështirësitë e nxënësve në shkrim dhe lexim janë më të mëdha.

Për të përcaktuar marrëdhënien ndërmjet suksesit të nxënësve në mësim dhe rezultateve të nxënësve në shkrim-lexim, zhvilluam korrelacionin e Perason-it. Vlerat e fituara treguan se ka lidhje të moderuar, pozitive, midis suksesit të nxënësve në mësim dhe rezultateve në shkrim-lexim ($r = .432^{**}$; $N=213$; $p=.000$).

Ushtrimet e nxënësve janë mjaft të rëndësishme për zhvillimin dhe përmirësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim. Por, *sa nxënësit u kushtojnë kohë dhe kujdes ushtrimeve në shkrim-lexim?* Të dhënat e studimit tregojnë se nxënësit shkruajnë vetëm atë që obligohen nga mësuesit, qoftë në klasë apo në detyra të shtëpisë. Vetëm 3.4% e nxënësve merren edhe me shkrime të tjera, shkruajnë, ngase dëshirojnë të përmirësojnë shkrimin ose u pëlqen të shkruajnë.

Ndërsa, sa i përket leximit, nxënësit lexojnë tekste të ndryshme, për të cilat obligohen nga mësuesit, ndërsa 17% e nxënësve deklarohen se lexojnë edhe tekste tjera, ngase u pëlqen të lexojnë, sidomos gjatë pushimeve verore.

Në pyetjen e parashtruar nxënësve, *çfarë dhe si ju pëlqen të lexoni?*, nga nxënësit morëm përgjigje të ndryshme. Numri më i madh i nxënësve, N=131 ose 61.50% e të anketuarve pëlqejnë të lexojnë vetë tregimet, e prej tyre N=27 ose 12.68% përveçqë u pëlqen të lexojnë vetë tregimet, pëlqejnë të shkruajnë dhe të komentojnë tregimet e lexuara, N=62 ose 29.11% e nxënësve pëlqejnë të dëgjojnë të tjerët duke lexuar, të shkruajnë apo të komentojnë për tregimet e dëgjuara, ndërsa N=20 ose 9.39% e nxënësve nuk janë përgjigjur fare.

Tabela 24. Qëndrimet e nxënësve lidhur me pyetjen çfarë dhe si ju pëlqen të lexoni?

<i>Çfarë pëlqejnë nxënësit për leximin?</i>	<i>Nr</i>	<i>%</i>
Të lexoj vetë tregimet	104	53,9
Të dëgjoj të tjerët duke lexuar	19	9,8
Të komentoj tregimet e lexuara	21	10,9
Të shkruaj për tregimet e lexuara	12	6,2
Tjetër	8	4,1
Të lexoj vetë tregimet dhe të shkruaj për tregimet e lexuara	7	3,6
Të lexoj tregimet dhe të dëgjoj të tjerët duke lexuar	3	1,6
Të lexoj tregimet dhe të komentoj tregimet e lexuara	4	2,1
Të lexoj vetë tregimet, t'i dëgjoj edhe të tjerët duke lexuar, t'i komentoj tregimet e lexuara, të shkruaj për tregimet e lexuara	2	1,0
Të lexoj tregimet, të komentoj tregimet e lexuara dhe të shkruaj për tregimet e lexuara	7	3,6
Të dëgjoj të tjerët duke lexuar dhe të komentoj tregimet e lexuara	2	1,0
Të lexoj vetë tregimet, t'i dëgjoj edhe të tjerët duke lexuar, të shkruaj për tregimet e lexuara	1	,5
Të lexoj tregimet dhe të shkruaj për tregimet e lexuara	3	1,6
Përgjigjur gjithsej	193	100,0
Nuk kanë dhënë përgjigje	20	
<i>Gjithsej të përfshirë</i>	213	100.0

Të dhënat nga tabela numër 24 tregojnë se te nxënësit ka interesim për leximin, qoftë duke praktikuar vetë leximin apo duke dëgjuar të tjerët. Në pyetjen tjetër të radhës, se *çfarë pëlqeni tjetër?*, përgjigjet e nxënësve raptojnë ishin të orientuara nga leximi, kuptimi, komentimi dhe shkrimi i tregimeve. Nga N=213 nxënës, të cilët u përgjigjën në pyetësorin e anketës, prej tyre N=186 ose 87.32% pëlqejnë të lexojnë vetë ose të dëgjojnë të tjerët duke lexuar, N=8 ose 3.76% pëlqejnë të lexojnë bashkë me të tjerët (motrën, gjyshen apo bashkëmoshatarët), N=17 ose 7.89% pëlqejnë të shkruajnë lidhur me leximin që bëjnë, të shkruajnë vetë poezi, tregime apo komentimin e tyre, ndërsa N=20 ose 0.94% pohojnë se duan ta kuptojnë mirë përmbajtjen që lexojnë.


Lidhur me pyetjen se *çfarë pëlqeni të lexoni?*, shumica e nxënësve u përgjigjën se pëlqejnë të lexojnë librat e shkollës (35.53%), lektyrat shkollë (23.44%), tregime për fëmijë (16.12%), vjersha për fëmijë (16.12%) dhe revista të ndryshme (8.79%).

Në pyetjen e parashtruar për nxënës, se sa kohë i kushtojnë leximit gjatë javës, nga pesë shkallët e kohës së leximit (1=Më pak se një orë, 2=1 deri 2 orë, 3=3 deri 4 orë, 4=4 deri 5 orë dhe 5= Më shumë se 6 orë), rezultatet tregojnë se mesatarja e kohës së leximit të nxënësve gjatë javës është $M=2.77$.

Tabela 25. Të dhëna përshkruese lidhur me kohën e leximit të nxënësve gjatë javës

	N	Rangimi	Minimum	Maximum	Devijimi		
					Mesatarja	Standard	Varianca
Gjatë javës lexon	208	4	1	5	2,77	1,165	1,357

Të dhënat e dala nga pyetësori tregojnë se numri më i vogël i nxënësve (9.6%) lexojnë më pak se një orë gjatë javës, ndërsa shumica e nxënësve (41.3%) lexojnë 1-2 orë gjatë javës.



Grafiku 3. Sa orë lexojnë nxënësit gjatë javës?

Lidhur me pyetjen se çka lexojnë më shumë?, nxënësit shprehen se lexojnë lektyra shkollore, enciklopedi, përralla e tregime që iu pëlqejnë, si dhe atë çka u jep si detyrë shtëpie mësimdhënësi i klasës, e që sipas nxënësve gati çdoherë detyrat e shtëpisë lidhen me leximin dhe shkrimin. Nxënësit pohojnë se mësimdhënësit i angazhojnë ata çdo ditë me detyra të shtëpisë. Shumica e nxënësve të përfshirë në studim pohojnë se për përfundimin me sukses të detyrave të shtëpisë u nevojitet ndihma e personave më të rritur në familje. Rezultatet e studimit tregojnë se në shumicën e rasteve ata të cilët ofrojnë mbështetje më të madhe për fëmijët e tyre gjatë përfundimit të detyrave të shtëpisë janë prindërit (65.4%), pastaj motrat dhe vëllezërit (29%), familjarët e tjerë (2.3%), ndërsa vetëm 3.3% e nxënësve pohojnë se nuk kanë nevojë për ndihmën e askujt, ngase detyrat e shtëpisë i kryejnë vetë.

Puna me nxënësit me vështirësi

Pas identifikimit të nxënësve me vështirësi, u organizua edhe puna me nxënës.

Fillimisht ishte e nevojshme të hartohet plani i veprimit të aktiviteteve që do të ndërmerren shkolla për punën me nxënës me vështirësi. Mësimdhënësit nga secila shkollë u ulën bashkërisht dhe hartuan planin e tyre të veprimit.

Orientimisht plani i veprimit duket kështu:

Tabela 26. Plan i veprimit, i hartuar nga stafi i shkollës për aktivitetet me nxënësit e identifikuar me vështirësi në shkrim-lexim

<i>Nr.</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Janar</i>	<i>Shkurt</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Maj</i>	<i>Qershor</i>
<i>1</i>	<i>Krijimi i grupeve të leximit dhe të shkrimit</i>	<i>X</i>					
<i>2</i>	<i>Hartimi i orarit të punës me nxënës</i>	<i>X</i>					
<i>3</i>	<i>Takimet me prindër</i>	<i>X</i>					
<i>4</i>	<i>Puna me grupet e leximit dhe të shkrimit</i>		<i>X</i>	<i>X</i>	<i>X</i>	<i>X</i>	
<i>6</i>	<i>Testimi i nxënësve që kanë qenë pjesë e grupeve të leximit</i>						<i>X</i>

Në planin e veprimit shkollat listuan aktivitetet që do të ndërmerren në faza të ndryshme të përgatitjeve, realizimit dhe vlerësimit të punës plotësuese me nxënës.

Datat e shënuara në tabelën e paraqitur më lart janë vetëm sa për ilustrim. Kryesisht, planet e veprimit të shkollave të përfshira në studim ishin të paraqitura këto aktivitete:

❖ **Formimi i grupeve të leximit dhe të shkrimit** - Pas rezultateve të testimit, shkollat bënë formimin e grupeve të leximit dhe të shkrimit, bazuar mbi rezultatet e vlerësimeve të nxënësve. Ky aktivitet ishte paraparë të realizohej brenda një dite, e që shumica e shkollave për këtë aktivitet kishin planifikuar takim të përbashkët me të gjithë mësimmshënësit e arsimit fillor, të cilët paraprakisht kishin marrë pjesë në punëtoritë e organizuara për këtë qëllim.

❖ **Hartimi i orarit të punës me nxënës** - Edhe për këtë aktivitet shumica e shkollave kishin planifikuar 1-2 ditë pune, e që sipas informatave të marra nga shkolla ky aktivitetet nuk ka marrë shumë kohë, vetëm se kishte nevojë për një konsultim dhe konsensus të përbashkët me të gjithë mësimmshënësit e përfshirë në këtë proces. Puna planifikohet të bëhet në grup dhe jashtë mësimit të rregullt, kështu që mësimmshënësit duhet të pajtoheshin për orarin e tyre.

Kujdes i veçantë mësimmshënësit pohuan se iu kushtua përmbajtjeve, të cilat do të ofroheshin për nxënësit, dhe orëve të planifikuara për këtë qëllim, në mënyrë që të mos ngarkoheshin as mësimmshënësit dhe as nxënësit me punë plotësuese. Bazuar në përvojën e tyre, mësimmshënësit sugjeruan që grupi i nxënësve të përbëhet nga 5-7 nxënës dhe me një grup të punojnë 2-3 mësimmshënës dhe secili nga mësimmshënësit të punojë 4 orë në muaj, ose 1 orë në javë punë plotësuese me nxënës, ndërsa nxënësit 2-3 orë plotësuese në javë.

Sipas mësimmshënësve të përfshirë në studim, puna e përbashkët e mësimmshënësve me një grup të caktuar të nxënësve ishte mjaft efektive.

Tabela 27. Plani orientues i punës me grupet e nxënësve me vështirësi

Grupet	Mësimmshënësit e angazhuar	Ditët e angazhimit	Ora/koha e angazhimit	Nxënësit e angazhuar	Lloji i vështirësisë
1					
2					
3					

❖ **Takimet me prindër** - U planifikuan dhe u organizuan para fillimit të punës me nxënës me vështirësi. U organizuan takime individuale me prindër të nxënësve që u përfshinë në grupet e leximit dhe të shkrimit. Në këto takime prindërit u informuan për:

- Arsyen e organizimit të mësimit plotësues për fëmijët e tyre;
- Mënyrën e organizimit të punës;
- Roli i prindit në mbështetjen e fëmijës me vështirësi;
- Kohëzgjatja e mësimit plotësues;
- Rezultatet e pritura.

Planifikimi i punës me nxënësit me vështirësi

Përveç planifikimeve të rregullta, të cilat mësimitdhënësit i hartuan (përgatitën) për klasën apo lëndën e caktuar, për fëmijët e identifikuar me vështirësi në shkrim-lexim, të cilët kishin nevojë për mësime plotësues, hartuan plane individuale, i cili u mundësoi mbështetjen e nevojshme për tejkalimin e vështirësive të caktuara. Planifikimi individual ishte pjesë përbërëse e planifikimit të përgjithshëm të mësimit nga ana e mësimitdhënësit.

Sikurse edhe planifikimet vjetore, dymujore, javore dhe ditore, të cilat u bazohen në rezultatet e pritura, edhe planet individuale për nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim u hartuan bazuar mbi rezultatet e pritura për nxënësin e caktuar.

Plani individual, i cili u përdor për mësime plotësues, është formë më e thjeshtësuar nga forma e dokumentit zyrtar pedagogjik të Planit Individual të Arsimit (PIA). PIA është dokument zyrtar pedagogjik për mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta, i cili bazën e ka në Ligjin për Arsim Parauniversitar (2011), Udhëzimin Administrativ për hartimin e PIA (UA 18/2013), strategjitë dhe Korniza e Kurrikulës, e cila mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes. Sipas këtyre dokumenteve në fuqi, obligohen të gjithë mësimitdhënësit, të cilët punojnë me fëmijë me

nevoja të veçanta arsimore, për të cilët është nxjerrë vendim nga ekipi vlerësues për punë me PIA, që të hartojnë dhe zbatojnë PIA-n.

Përderisa për nxënësit me nevoja të veçanta të theksuara vendimi për PIA nxirret nga ekipi vlerësues komunal, apo nga Qendra Burimore, për nxënësit me vështirësi në lexim-shkrim u planifikua qasje individuale dhe u hartuan plane individuale, bazuar në aftësitë, mundësitë, nevojat, dhe stilet e të nxënësve të nxënësve.

Përderisa PIA për nxënësin hartohet bazuar në vendimin e ekipit vlerësues, për një apo më shumë lëndë mësimore - varësisht nga nevojat e nxënësve, Plani Individual për Mësim Plotësues ishte një formë e thjeshtësuar e planit, e cila u hartua për nxënësit, të cilët gjatë zhvillimit të këtij programi u identifikuan me vështirësi në lexim-shkrim dhe është dizajnuar vetëm për nevojat e këtij programi.

Informatat e nevojshme për planifikim individual të nxënësve me vështirësi në lexim-shkrim mësimdhënësve iu ofruan gjatë punëtorive dyditore të organizuara për këtë qëllim, si dhe një model i plani, bashkë me udhëzuesin për plotësim, mësimdhënësve iu shpërnda edhe në kopje fizike.

Të dhënat e nxënësve në planin për mësim plotësues ndahen në dy pjesë: të përgjithshme dhe specifike. Në pjesën e parë shënohen informata të përgjithshme të planifikimit për mësim plotësues dhe plotësohet para fillimit të mësimin plotësues me nxënës, ndërsa në pjesën e dytë shënohen informata specifike të planifikimit për një orë mësimore dhe plotësohet secilën ditë të mbajtjes së mësimin plotësues (sikurse plani ditor për klasën). Ky plan duhet plotësuar në bazë të këtyre udhëzimeve:

Udhëzime për hartimin e Planit Individual për mësimin plotësues

Pjesa I: LËNDA E INDIVIDUALIZUAR

Lënda e individualizuar: (Shënohet lënda, p.sh. Gjuhë Shqipe)

Nxënësi: (Shënohet emri dhe mbiemri i nxënësit)

Klasa: (Shënohet klasa në të cilën nxënësi vijon mësimin, p.sh. klasa e tretë)

Numri i orëve të përcaktuara: (Shënohet numri i orëve të planifikuara për mësim plotësues)

Emri i mësimdhënësit: (Shënohet emri i mësimdhënësit, i cili realizon mësimin plotësues)

Gjendja momentale e nxënësit në lëndën e Gjuhës Shqipe: (Shënohet çfarë di nxënësi në lëndën e Gjuhës Shqipe dhe vështirësitë që ka, p.sh.:

- Nxënësi X.Y. i njeh shkronjat A, a, N,n, I,i, O,o,, të dorës, por ka probleme të theksuara me shkronjat s, sh, r, rr, th, p, q, apo i ngatërron ato etj.;
- Nxënësi nuk mund të bashkojë shkronjat dhe të formojë rrokje;
- Lexon vetëm përmes germëzimit;
- Ka vështirësi të theksuara edhe në shkrimin e shkronjave, fjalëve etj.).

Qëllimi i organizimit të mësimin plotësues: Shënohet pikësynimi që dëshirojmë të arrijmë për një periudhë të caktuar, me qëllim të tejkalimit të vështirësive të identifikuar të nxënësit, si p.sh:

- Njohjes dhe përvetësimit të shkronjave S, s, R, r, ... të shtypit dhe të dorës;
- Dallimit të shkronjave p- q, sh- th,....
- Shkrimit të shkronjave...
- Bashkimit të shkronjave dhe tingujve dhe krijimin e rrokjeve;
- Leximin dhe shkrimin e fjalëve;

- Bashkimit të fjalëve dhe krijimin e fjalive të thjeshta etj.

Rezultatet e pritura (për të gjitha orët e planifikuara të mësimit plotësues): shënohen rezultatet e përgjithshme që pritet t'i arrijë nxënësi në fund të periudhës sa pritet të zgjasë mësimi plotësues), p.sh:

- Njih shkronjat S, s, R, r, ...
- Shkruan shkronjat S, s, R, r, ...
- Dallon shkronjat p-q, t-f, gj-xh...
- Shqipton tingujt: s, r, th,....
- Bashkon rrokjet ANI- SA, LU-A-NI, O-RA, DO-RA,
- Ndan fjalët në rrokje: PULA, ARIU, ROSA,
- Lexon dhe shkruan saktë;
- Bashkon fjalë dhe krijon fjali.

Vlerësimi i rezultateve: Shënohet në fund të procesit të planifikimit individual, duke përshkruar rezultatet e arritura në raport me planifikimin individual), p.sh: nxënësi ka arritur t'i njohë, t'i shkruajë, t'i dallojë shkronjat e caktuara, të lidhë rrokjet etj.

Pjesa II: PLANIFIKIMI PËR ORË MËSIMORE

Ora mësimore: (p.sh. Ora e parë; I);

Data: (Data kur mbahet ora mësimore);

Qëllimi: Shënohet qëllimi për orën mësimore; p.sh. njohja e shkronjave S, s, R, r.

Rezultatet e pritura: P.sh.

- Njeh shkronjat S, s, R, r,
- Shkruan shkronjat S, s, R, r,
- Shqipton shkronjat e mësuara etj.

Kritere të suksesit

- Në mësim e shkronjave tjera gjej shkronjat S, s, R, r,
- Shkruaj bukur me shkronja dore shkronjat S, s, R, r,
- Shqipto saktë shkronjat S, s, R, r,

Materialet didaktike: Shënohen materialet, të cilat do të përdoren për realizimin e qëllimit të orës mësimore: shkronja, fletëza pune, plastelinë, kompjuteri,...etj.

Forma e punës: (individuale, në çift, në grup....etj.)

Vlerësimi i rezultateve: (Bëhet pas përfundimit të orës mësimore me nxënësin), p.sh: nxënësi njeh dhe shkruan shkronjat s,r, por nuk i shqipton saktë ato,... etj. (shih në vijim formën e Planit Individual për mësim plotësues).

Bazuar në vlerësimin e dosjeve të mësimdhënësve, të gjithë mësimdhënësit kanë punuar me plane individuale dhe për secilin nxënë të përfshirë në mësim plotësues kishte plan individual, për çdo ditë të evidentuar si orë plotësuese.

Numri i planeve individuale për nxënës varet nga numri i orëve të përfshira në mësimin plotësues.

Tabela 28. Të dhëna përshkruese lidhur me orët e planifikuara për mësim plotësues

	N	Rangimi	Minimum	Maximum	Mesatarja	Devijimi Standard	Variance
Numri i orëve plotësuese	363	12	5	17	12,79	3,756	14,107

Puna me grupet e leximi-shkrimit

Puna me nxënësit me vështirësi u organizua nga mësimdhënësit, si formë e punës plotësuese. Varësisht prej vështirësive, gjatë muajve shkurt, mars, prill, maj dhe gjysmën e parë të qershorit, me grupet e nxënësve është punuar punë plotësuese, për tejkalimin e vështirësive të identifikuara në shkrim-lexim.

Nga dy vlerësimet e para, u identifikuan N=495 nxënës të përfshirë në vlerësimin e dytë, prej tyre N=445 ose 90% u identifikuan me vështirësi në aspekte të ndryshme të leximit dhe të shkrimit. Puna plotësuese mundësoi që një numër i konsiderueshëm i nxënësve, më saktësisht N=82 ose 18.42 % prej tyre, të tejkalojnë problemet në shkrim ose në lexim vetëm me disa orë plotësuese. Pas vlerësimit nga ana e mësimdhënësve, se nxënësit kanë përmirësuar në nivel të kënaqshëm shkathtësitë e tyre në shkrim-lexim, ata e ndërprejnë mësimin plotësues.

Ndërsa, për N=363 nxënës të tjerë u organizua mësim plotësues deri në përfundim të vitit shkollor (deri në maj, ose në javën e parë të muajit qershor, varësisht se si ishte planifikuar nga shkollat).

Niveli i vështirësisë së nxënësve ishte i ndryshëm, duke filluar nga njohja e shkronjave deri te kuptimi i lexim-shkrimit. Shumica e nxënësve të përfshirë në mësimin plotësues, 70.6% prej tyre, kishin vështirësi në shkrim-lexim, 24.1% kishin vështirësi vetëm në shkrim, ndërsa 5.3%

kishin vështirësi vetëm në lexim. Shumica e nxënësve të përfshirë në mësimin plotësues ishin nxënës së klasës së pestë N=169 ose 46.6%, nxënës të klasës së katërt ishin N=113, ose 31.1%, ndërsa nxënës të klasës së tretë ishin N=81 ose 22.3%.

Numri i orëve plotësuese nuk ishte i njëjtë për të gjithë nxënësit.

Tabela 29. Numri i nxënësve të përfshirë në punë plotësuese, sipas orëve

Numri i orëve plotësuese	10	11	12	13	14	15	16	17	Gjithsej
Numri i nxënësve të përfshirë	22	29	68	63	35	24	45	77	363
Përqindja e nxënësve të përfshirë	6.06	7.99	18.73	17.36	9.64	6.61	12.40	21.21	100.00

Gjatë punës me grupet e leximit dhe të shkrimit është bërë mentorimi i mësimdhënësve që kanë punuar me këto grupe të nxënësve. Qëllimi i mentorimit ishte përkrahja e mësimdhënësve në ofrimin e mbështetjes së nxënësve, për tejkalimin e vështirësive të nxënësve në shkrim dhe në lexim. Mentorimi është bërë në periudhën mars-qershor, nga hulumtuesit e IPK-së.

Gjatë procesit të mentorimit është parë se me nxënësit e përfshirë në punë plotësuese është punuar sipas orareve dhe planeve të hartuara nga mësimdhënësit. Përkushtimi ishte mjaft i madh, si nga ana e nxënësve ashtu edhe nga ana e mësimdhënësve. Puna e përbashkët e mësimdhënësve ishte mjaft atraktive për nxënësit, sepse krijonte mundësi që me nxënësit e njëjtë të punohet me metodologji të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies, e cila, sipas opinionëve të marra nga nxënësit, ishte më atraktive sesa puna e përditshme në klasë. Puna e përbashkët e mësimdhënësve i ka ndihmuar mësimdhënësit edhe në krijimin e materialeve didaktike, përdorimin e tyre me nxënës, planifikimin e përbashkët, por edhe në vlerësimin e punës së tyre dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

Përdorimi i materialeve didaktike për të përmirësuar shkathtësitë e shkrimit

Për arritjen sa më të shpejtë dhe më të lehtë të rezultateve mësimore, është mjaft me rëndësi përdorimi i materialeve dhe burimeve të përshtatshme mësimore për mësimdhënie dhe nxënie. Gjithashtu, e rëndësishme është që edhe mjetet dhe materialet mësimore, të cilat përdoren me nxënës, t'u përmbahen kërkesave të këtyre rezultateve, mundësive psikofizike të nxënësve, përvojave, kulturës dhe stileve të nxënies së tyre.

Për të arritur më lehtë dhe më shpejt rezultatet e përcaktuara për nxënësit e përfshirë në mësim plotësues, mësimdhënësit përdorën tekste dhe materiale tjera mësimore, të përshtatshme për ta. Tekstet shkollore ishin vetëm disa nga burimet për marrjen e informacionit, nuk ishin burim i vetëm. Gjatë punës plotësuese, mësimdhënësit përdoren edhe teknologjinë informative, lloptop, projektor etj. Te mësimdhënësit shihej interesim i madh lidhur me shfrytëzimin e çdo burimi, i cili ndihmon në arritjen e rezultateve të përcaktuara për nxënës.

Përveç teksteve dhe materialeve tjera mësimore, të cilat mësimdhënësit i posedonin, bazuar në njohuritë dhe nevojat e nxënësve, adaptuan dhe prodhuan edhe materiale të përshtatshme për nxënës.

Materialet, të cilat u përdorën nga mësimdhënësit gjatë punës plotësuese me nxënës, ishin kryesisht fleta pune dhe instrumente vlerësuese.

GJEJË DHE QARKO SHKRONJËN A

F M A U Y Q A X H L O D H A
 J X S A Z H N C N J L L Ë K T
 A S H D G G J A R P I A T H I
 F M H A Y Q B A L O D H J
 A X S E Z H N A N J L L Ë K T
 V S H A G G J Z R A R R Q T H I
 A M H U Y Q A X H L O D H A
 J X S A Z H N C N J L L A K T
 V S H D A G J Z R A R R Q T H I
 F M H A Y Q B A L O D H U
 A X S E Z H N C N J L L A K T
 V S H D G G J Z A P R R Q T H A
 F M H A Y Q B X H L A D H S
 J X A E Z H N A N J L L Ë K T
 A S H D G G J Z R A R R Q T H I

Lexojmë dhe shkruajmë

Gjithçka rreth shkronjës A a



Shkruaj shkronjën A a.

A A A A A A a a a a a a
 A A A A A A a a a a a a
 A A A A A A a a a a a a

Shkruaj shkronjën A në hapësirën e zbrazët.

Qarko të gjitha shkronjat A a në fjalët e dhëna.



__ E R O P L __ N

ARA	ariu
ERA	barka
MALI	dora
ARTA	anija

Ngjyros figurat dhe qarko shkronjën A a në emrat e shënuar poshtë.



Aeroplani



Dora



Lulja

Figura 4. Fleta pune të përdorura me nxënës

Në figurën numër 3 janë paraqitur fleta pune të përdorura me nxënës. Të dyja kanë qëllimin e njëjtë, njohjen e shkronjës A. E para është përdorur në fazën e njohjes për shkronjën A, ndërsa e dyta si ushtrim për njohjen dhe shkrimin e shkronjave A dhe a.

Materiale të ngjashme janë përdorur edhe për shkronjat e tjera:





Figura 5. Përdorimi i materialeve mësimore gjatë punës me nxënës

Sipas mësimdhënësve, të cilët punuan me grupet e nxënësve me vështirësi, puna me materialet mësimore ishte atraktive për nxënës.

E veçanta e materialeve ishte se ato ishin hartuar mbi bazën e nevojave dhe mundësive të nxënësve të përfshirë në mësimin plotësues dhe përshtateshin shumë me nevojat e nxënësve.

Të dhënat e mbledhura gjatë mentorimit dhe përmes pyetësorit e analizës së dosjeve të mësimdhënësve tregojnë se mësimdhënësit, kryesisht, kishin në përdorim materialet mësimore të ofruara në fillim nga projekti, të cilat iu dhanë si model mësimdhënësve, dhe materiale tjera, të cilat u hartuan gjatë trajnimit dyditor me mësimdhënës. Vetëm në 17% të dosjeve të vlerësuara u pa se kishte edhe materiale tjera, të hartuara nga vetë mësimdhënësit.

Vlerësimi i nxënësve që kanë qenë pjesë e grupeve të leximit dhe të shkrimit

Për nxënësit pjesëmarrës në grupet e leximit dhe të shkrimit, pas përfundimit, u organizua vlerësimi i tyre për të parë përparimin dhe tejkalimin e vështirësive si rezultat i punës së grupeve të leximit dhe të shkrimit. Për këta nxënës në përfundim të punës plotësuese u organizua vlerësimi në shkrim dhe në lexim, i cili kishte për qëllim matjen e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim, përmirësimin e tyre si rezultat i punës plotësuese.

Vlerësimi u organizua për N=363 nxënës të cilët ishin të përfshirë në mësim plotësues, prej tyre vetëm N=81 ose 22.31% nga klasa e tretë, N=113 ose 31.13% nga klasa e katërt ndërsa N= 169 ose 46.56% ishin nxënës së klasës së pestë.

Numri më i madh i nxënësve të përfshirë në mësimin plotësues kanë tejkaluar ose kanë përmirësime në shkrim-lexim (N=119 kanë tejkaluar vështirësitë, ndërsa N=161 kanë përmirësime në shkrim-lexim).

Tabela 30 përmban të dhënat nga rezultatet e nxënësve në vlerësimin e tretë në shkrim-lexim.

Tabela 30. Rezultatet e nxënësve në vlerësimin e tretë në shkrim-lexim

Klasa	Ka tejkaluar		Ka		Nuk ka		Gjithsej	
	vështirësitë		përmirësime		përmirësime			
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
E tretë	19	15.97	39	24.22	23	27.71	81	22.31
E katërt	44	36.97	43	26.71	26	31.33	113	31.13
E pestë	56	47.06	79	49.07	34	40.96	169	46.56
Gjithsej	119	100.00	161	100.00	83	100.00	363	100.00

Dëshmi për rezultatet e nxënësve dhe për arritjet e tyre i kishim dosjet e nxënësve, raportet e mësimdhënësve, dhe rezultatet e nxënësve nga vlerësimi i fundit. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në punën plotësuese, N=280 ose 77.13% prej tyre i kanë përmirësuar shkathtësitë e shkrim-leximit.

Sa u përket klasave, numri më i madh i nxënësve të përfshirë në mësim plotësues ishin nxënësit e klasës së pestë N=169 ose 46.56%. Ndërsa përqindja më e madhe e nxënësve, të cilët i kanë përmirësuar shkathtësitë e tyre në shkrim-lexim, ishte nga klasa e tretë (N=39 ose 48%), ndërsa numri më i madh i nxënësve që kanë tejkaluar vështirësitë ishin nga klasa e katërt (N= 44 ose 39.94%). Tabela 31 tregon krahasimin e rezultateve mes klasave:

Tabela 31. Krahasimi i rezultateve të nxënësve sipas klasave (rezultateve nga vlerësimi i tretë në shkrim-lexim)

Klasa	Ka tejkaluar		Ka		Nuk ka		Gjithsej	
	vështirësitë		përmirësime		përmirësime			
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
E tretë	19	23.46	39	48.15	23	28.40	81	22.31
E katërt	44	39.94	43	38.05	26	23.00	113	31.13
E pestë	56	33.14	79	46.75	34	20.12	169	
Gjithsej	119	32.78	161	44.35	83	22.87	363	

Nga N=169 nxënësit e përfshirë në mësimin plotësues, N=135 ose 79.88% prej tyre i kanë përmirësuar shkathtësitë e shkrimit dhe leximit. Nga N=113 nxënës të klasës së katërt, N=87 ose 76.99% i kanë përmirësuar shkathtësitë e tyre në shkrim-lexim, ndërsa nga N=81 nxënës së klasës së tretë, N=58 ose 71.60% kanë përmirësuar shkathtësitë e shkrim-leximit. Marrë në përgjithësi, mbi 70% e nxënësve të përfshirë në mësim plotësues i kanë përmirësuar shkathtësitë e tyre në shkrim-lexim.

Diskutim i rezultateve

Qëllimi i këtij studimi ishte identifikimi i vështirësive të nxënësve në shkrim-lexim, si dhe mundësitë e tejkalimit të tyre si rezultat i mbështetjes së ofruar.

Studime të ndryshme lidhur me leximin dhe shkrimin tregojnë se leximi dhe shkrimi janë dy procese të ndërlidhura. Ato mbështeten në themel të përbashkët dhe bazë e tyre janë shkronjat/tingujt, por studimet e ndryshme japin versione të ndryshme lidhur me marrëdhëniet ndërmjet shkronjave, fjalëve, fjalive e tekstit, në gjuhën e shkruar, dhe analizën e informacionit gjuhësor të tekstit të dhënë. Shumica prej autorëve vënë në pah rëndësinë e njohjes së shkronjave, si dhe aftësitë e gjuhës së folur në përvetësimin e shkrim-leximit.

Por, të gjithë pajtohen se mësimi i shkrimit dhe mësimi i leximit janë dy procese, të cilat kërkojnë angazhim dhe mbështetje të vazhdueshme.

Në dokumentet zyrtare janë përcaktuar kompetencat, shkallët dhe fushat, rezultatet e së cilave ndihmojnë në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit përmes fushës Gjuhët dhe komunikimi, respektivisht rezultateve të të nxënësve për këtë fushë, ndihmon në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim dhe lexim. Për secilën fushë dhe lëndë janë të përcaktuara rezultatet mësimore, të cilat përcaktojnë njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë e nxënësve, të cilat duhet të zhvillohen dhe thellohen gradualisht për secilën shkallë.

Në planet dhe programet mësimore për lëndën Gjuhë Shqipe janë përcaktuar konceptet, temat dhe rezultatet e të nxënit të lëndës për temë. Elementet bazë të shkrimit dhe leximit përvetësohen në shkallën e parë.

Qysh në klasën përgatitore, fëmijët fillojnë të mësojnë elementet e para të shkrimit dhe të leximit, por që në këtë klasë fokusi është në shkathtësitë e komunikimit, të cilat te fëmijët duhet të arrihen përmes të folurit, vizatimeve, këngës dhe lojës.

Ndërsa, në klasën e parë dhe të dytë përvetësohen elementet bazë të shkrimit dhe të leximit, të cilat arrihen përmes rezultateve dhe temave të përcaktuara nëpërmjet sistemit gjuhësor, që mësimdhënësi duhet t'i realizojë nëpërmjet shkathtësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Rezultatet e studimeve të bëra në vende të ndryshme, lidhur me vlerësimin e shkrimit dhe leximit fillestar, tregojnë se është në rritje shqetësimi lidhur me mungesën e aftësive të nevojshme të nxënësve për shkrim-lexim.

Vlerësimet e bëra në Kosovë, po ashtu, tregojnë për një numër relativisht të madh të nxënësve që nuk i kanë përvetësuar shkathtësitë e shkrim-leximit fillestar.

Lidhur me pyetjen e studimit *si mund të identifikohen vështirësitë në shkrim dhe në lexim?*, interesi ynë ishte të marrim informacion nga praktikatat e mësimdhënësve, se si i identifikojnë nxënësit me vështirësi dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen ata.

Përvojat e mësimdhënësve në këtë drejtim kufizoheshin vetëm në punën e tyre në klasë, në vlerësimet e rregullta të nxënësve për lëndën e gjuhës.

Në shkollat që u realizua studimi, së paku deri në kohën e realizimit të studimit, nuk ishte ndërmarrë ndonjë aktivitet për një qëllim të tillë. Aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit të studimit, instrumentet e ofruara, materialet për punë me nxënës, metodologjia e përdorur dhe mbështetja profesionale, ishin një përvojë dhe mundësi e mirë për

mësimdhënësit që të bëjnë identifikimin e nxënësve me vështirësi dhe ofrimin e mbështetjes për ta. Ata bashkëpunuan ngushtë me hulumtuesit e IPK-së gjatë identifikimit dhe punës me nxënës dhe kjo i ndihmoi ata të përgatiten profesionalisht në këtë aspekt.

Se cilat janë vështirësitë e nxënësve në shkrim dhe lexim e tregojnë rezultatet e studimit. Sipas të dhënave të dala nga studimi, nxënësit e arsimit fillor përballen me vështirësi në shkrim dhe në lexim. Në vlerësimin e parë, 54.15% e nxënësve të përfshirë ishin nën mesataren e pritur, gjë që tregon se më shumë se gjysma e nxënësve kanë probleme të theksuara me shkrim-leximin. Kjo është mjaft shqetësuese, sidomos duke e pasur parasysh faktin se në vlerësim u përfshinë nxënësit e shkallës së dytë, nxënësit e klasës së tretë, të katërt dhe të pestë, e që sipas kërkesave të kurrikulës, në përfundim të shkallës së dytë nxënësi mëson elementet bazë të shkrimit dhe të leximit, pra mëson të shkruajë, e të lexojë drejt, rrjedhshëm dhe pa gabime.

Për të parë më saktësisht se me cilat vështirësi ballafaqohen nxënësit në lexim dhe në shkrim, u organizua vlerësimi i dytë, i cili ishte individual, dhe u realizua me të gjithë nxënësit, të cilët nuk treguan rezultate në vlerësimin e parë. Vlerësimi i dytë verifikoi të dhënat e dala nga vlerësimi i parë, ngase edhe vlerësimi i dytë tregoi se 90% e nxënësve të identifikuar si nxënës me vështirësi në vlerësimin e parë ballafaqohen me vështirësi në shkrim dhe në lexim.

Bazuar në të dhënat e dala nga vlerësimi i dytë, rezulton se shumica e nxënësve të përfshirë në studim kanë vështirësi në të dyja këto shkathësi, në shkrim dhe në lexim. Vështirësitë e nxënësve në shkrim dhe në lexim kanë të bëjnë me njohjen e shkronjave, emërtimin e tyre, bashkimin dhe heqjen e rrokjeve, leximin dhe shkrimin e rrokjeve, fjalëve e fjalive.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve, të cilët nuk i njohin shkronjat, përqindja më e madhe prej tyre janë nxënës të klasës së pestë, por nëse analizat bëhen në nivel klase, del se përqindja më e madhe e nxënësve, të cilët nuk i njohin shkronjat, janë nxënës të klasës së tretë.

Sa u përket vështirësive në shkrim, rezultatet tregojnë se vështirësitë e nxënësve kanë të bëjnë me njohjen dhe emërtimin e shkronjave, shpejtësinë e shkrimit (janë të ngadalshëm në shkrim) dhe drejtshkrim. Ndërsa, vështirësitë e nxënësve në lexim lidhen po ashtu me shkrimin dhe njohjen e shkronjave, leximin e rrokjeve, leximin e fjalëve dhe shpejtësinë e leximit.

Studimi vë në pah edhe rëndësinë e ushtrimeve të nxënësve në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim dhe në lexim, pasi, sipas rezultateve, vetëm 3.4% e nxënësve merren edhe me shkrime e lexime tjera, përveç detyrave dhe përmbajtjes së obliguar nga mësimdhënësi. Kjo tregon edhe faktin se sa nxënësit tanë janë të edukuar dhe të motivuar për shkrim-lexim. Edhe koha që nxënësit i kushtojnë leximit është mjaft e kufizuar dhe, sipas të dhënave, shumica e nxënësve lexojnë 1-2 orë gjatë javës.

A ndihmon puna plotësuese/mbështetja shtesë, e ofruar për nxënësit, në eliminimin e vështirësive në shkrim-lexim, ishte njëra nga pyetjet e studimit.

Sipas të dhënave të mbledhura nga mësimdhënësit, shkollat më parë nuk kishin ndonjë praktikë të veçantë të mbështetjes shtesë të ofruar për nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim. E vetmja ndihmë që iu ofrohej ishte angazhimi i veçantë (në disa raste) gjatë orës mësimore, mësimi të rregullt.

Në kuadër të projektit të studimit, për mësimdhënësit u ofrua mbështetje edhe në këtë aspekt. Pas identifikimit të nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim, u krijuan grupet e leximit dhe të shkrimit, u ndanë përgjegjësitë e mësimdhënësve për grupet e nxënësve dhe u organizua puna me nxënësit me vështirësi.

Mbi bazën e dëshmive të ofruara nga vlerësimi i nxënësve dhe dëshmive paraprake që kishin për nxënësit e tyre, mësimdhënësit hartuan plane individuale për nxënësit me vështirësi. Planet individuale, me të cilat u shërbyen mësimdhënësit, nuk ishin forma zyrtare e Planit Individual të Arsimit, por ishin plane të përshtatura për nevojat e nxënësve, në të cilat

përfshiheshin të dhëna për nxënësit, për njohuritë që ka për lëndën dhe rezultatet e pritura për lëndën brenda periudhës së planifikuar për mësim plotësues, ndërsa në planin ditor përfshiheshin të dhëna për rezultatet e pritura për orë të mësimore, metodologjinë e punës me nxënës, dhe vlerësimin e arritjeve për orën mësimore.

Individualizimi i mësimit dhe puna plotësuese me nxënës ndihmuan në përmirësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim. Këtë e dëshmojnë edhe rezultatet e studimit, sipas së cilave 77.41% e nxënësve të përfshirë në mësimin plotësues kanë tejkaluar vështirësitë e tyre në shkrim-lexim. Gjatë punës me nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim mësimdhënësit bashkëpunuan ngushtë ndërmjet vete. Puna e përbashkët, përdorimi i metodologjive dhe materialeve të ndryshme mësimore, ndihmuan mësimdhënësit në arritjen më të lehtë dhe më të shpejtë të rezultateve të përcaktuara me nxënës.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga studimi dolën në pah gjetjet, të cilat mund të shërbejnë për përmirësimin e praktikave të mësimdhënësve në identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes së nxënësve për tejkalimin e tyre. Aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve në shkrim janë përcaktuar qartë në dokumentet zyrtare, si në Kornizën Kurrikulare, Kurrikulën Bërthamë, dhe programet mësimore zyrtare, prandaj mësimdhënësit duhet të punojnë dhe të fokusohen në rezultatet e përcaktuara në fushën e Gjuhët dhe komunikimi, të cilat përcaktojnë njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë e nxënësve në shkrim-lexim.

Rezultatet e studimit tregojnë se nxënësit e arsimit fillor përballen me vështirësi në shkrim-lexim. Vështirësitë e identifikuara të nxënësit në shkrim kanë karakter njohës, fonetik, leksikor dhe morfologjik, të cilat më parë nuk ishin identifikuar, apo ishin identifikuar vetëm sipërfaqësisht, të disa nga nxënësit, si nxënës me vështirësi në shkrim ose në lexim, duke mos u specifikuar vështirësitë e tyre.

Për identifikimin e vështirësive të nxënësve, në shkollat e përfshira në studim, nuk ishte ndërmarrë ndonjë aktivitet i veçantë, përveç vlerësimit të rregullt të nxënësve, ndërsa rezultatet e studimit vënë në pah se, përveç përcjelljes sistematike të nxënësve, është i nevojshëm edhe një vlerësim individual i nxënësve. Për këtë, mësimdhënësit dhe shkolla, në përgjithësi, duhet të angazhohen, të përzgjedhin instrumente të përshtatshme, dhe të identifikojnë vështirësitë e nxënësve në shkrim-lexim.

Nxënësit me vështirësi kanë nevojë për mbështetje. Ofrimi i mbështetjes ndihmon në përmirësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim. Rezultatet e studimit tregojnë se në shkollat e përfshira nuk është ofruar mbështetje shtesë për nxënësit me vështirësi, ndërsa studimi ynë tregon se organizimi i tyre ndihmon në përmirësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim.

Studimi vë në pah rëndësinë që kanë përkushtimi dhe puna plotësuese me nxënësit që nuk arrijnë rezultate të kënaqshme në mësim. Prandaj, rekomandojmë:

- Mësimdhënësit t'u ofrojnë mundësi nxënësve të zhvillojnë potencialin e tyre, duke planifikuar, organizuar dhe siguruar metodologji të ndryshme, të përshtatshme për zhvillimin dhe përmirësimin e shkathtësive të nxënësve në shkrim-lexim, si dhe të hartojnë dhe të përdorin materiale mësimore të ndryshme, atraktive dhe të përshtatshme për moshën kronologjike, interesat dhe aftësitë e tyre;

- Nxënësit të inkurajohen dhe të motivohen për arritjet e tyre, sado të vogla që janë ato. Inkurajimi dhe motivimi i nxënësve se ata dinë dhe munden ndihmon shumë në arritjen e rezultateve në shkrim-lexim;

- Mbështetja e nxënësve për tejkalimin e vështirësive në mësim duhet të jetë prioritet i mësimdhënësit, por edhe i shkollës. Bashkëpunimi dhe përkushtimi i stafit të shkollës, por edhe i nxënësve, në aspekte të ndryshme të shkrimit dhe të leximit, të tilla si ushtrimet dhe përsëritjet, i ndihmojnë nxënësit të përmirësojnë shkathtësitë e tyre në shkrim-lexim.

- Organizimi i klubeve dhe grupeve të ndryshme brenda shkollës i nxit nxënësit të merren më shumë me aktivitete të ndryshme që lidhen me shkrim-leximin.

Marrë në përgjithësi, për identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim nevojiten angazhim, vullnet i mirë, punë dhe përkushtim, si nga ana e mësimeve po ashtu edhe e nxënësve.

REFERENCAT

1. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1976). Fjalori drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, Tiranë.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (2002). Rregullat e pikësimit në Gjuhën Shqipe, ‘Shkenca’, Tiranë.
3. Ahmed Y., Wagner R.K., Lopez D. (2014). Marrëdhëniet zhvillimore ndërmjet leximit dhe shkrimit të fjalëve, fjalive dhe tekstit, *Journal of Educational Psychology*.
4. Altemeier, L. E., Abbott, R. D., & Berninger, V. W. (2008). Executive functions for reading and writing in typical literacy development and dyslexia. *Journal of Clinical and Experimental Neuropsychology*, 30, 588–606.
5. Berisha R., Jashari Sh. (2015). Vështirësitë e nxënësve në lexim, Basic Education program, Raport për kursin Hulumtimi në veprim.
6. Berninger, V. W., Abbott, R. D., Nagy, W., & Carlisle, J. (2010). Growth in phonological, orthographic, and morphological awareness in grades 1 to 6. *Journal of Psycholinguistic Research*, 39, 141–163.
7. Berninger, V. W., Nagy, W., & Beers, S. (2011). Child writers’ construction and reconstruction of single sentences and construction of multi-sentence texts: Contributions of syntax and transcription to translation. *Reading and Writing*, 24, 151–182.
8. Brada, R. (2010). Didaktika kibernetike, Teoria dhe praktika e mësimimit bashkëkohor, Prishtinë.

9. Brada, R. (2005). Metodika e Gjuhës Shqipe për shkollën fillore, Biblioteka Pedagogjike, Prishtinë.
10. Carretti, B., Motta, E., & Re, A. M. (2014). Oral and written expression in children with reading comprehension difficulties. *Journal of Learning*
11. Cohen, Sh., Glass, D. C., & Singer, J. E. (1973). "Apartment noise, auditory discrimination, and reading ability in children". *Journal of Experimental Social Psychology*. 9 (5): 407–422.
12. Costa, L.J.C., Ewards, N.C., & Hooper, S.R., (2015). Writing Disabilities and Reading Disabilities in Elementary School Students: Rates of Co-Occurrence and Cognitive Burden, Hammil Institute on Disabilities, Learning Disability Quarterly 1-4,
13. FSIESK, (2013). Raport nga rezultatet e vlerësimit të leximit dhe shkrimit në Kosovë, FSDEK II, Prishtinë.
14. Hayes, J. R., & Berninger, V. (2010). Relationships between idea generation and transcription: How act of writing shapes what children write. In C. Braverman, R. Krut, K. Lunsford, S. McLeod, S., Null, P., Rogers, & A. Stansell (Eds.), *Traditions of writing research* (pp. 166–180). New York: Taylor and Frances/Routledge.
15. Hower, L., Stein, V., Ackerman J., Kantz, M.J., McCormick, K., & Peck, W. C. (1990). *Reading to write- Exploring a Cognitive and Social Process*, Oxford University Press, New York Oxford.
16. Hoover, A.W., Gough P.B., (1990). *The Simple View of Reading*, University of Texas, U.S.A.
17. Bytyqi, B., L. (2014), Gjendja e planifikimit dhe realizimit të mësimit plotësues për nxënësit e shkollës fillore në Kosovë, Revista Pedagogjike, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.

18. Bytyqi, B., L. (2018), Zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të nxënësve në shkrim, Revista Pedagogjike, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
19. Instituti i Studimeve Pedagogjike, (2003). Programi i lëndës së Gjuhës Shqipe - abetare, klasa I, cikli fillor i shkollës 9-vjeçare, Tiranë.
20. Karamitri, E., Petriti, K., Murthi, L., & Pepa, V., (2001). Letërsi në shkollë, AEDP, Tiranë.
21. Kristen D. Ritchey and David L. Coker, Jr.(2014). Identifying Writing Difficulties in First Grade: An Investigation of Writing and Reading Measures, Learning Disabilities Research & Practice, 29(2), 54–65.
22. MASHT, (2004). Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve, Prishtinë.
23. MASHT, (2005). Plani dhe programi mësimor për klasën e katërt fillore, Prishtinë.
24. MASHT, (2005). Plani dhe programi mësimor për klasën e pestë fillore, Prishtinë.
25. MASHT, (2005). Plani dhe programi mësimor për klasën e tretë fillore, Prishtinë.
26. MASHT, (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar), Prishtinë.
27. MASHT, (2011). Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Prishtinë.
28. MASHT, (2016). Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, Prishtinë.

29. Mbështetja finlandeze për sistemin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë, 2011-2013, (2013). Raport nga rezultatet e vlerësimit të leximit dhe shkrimit në Kosovë.
30. Mehmeti, S. (2014). Provimi i Maturës në Kosovë, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
31. Memushaj, R. (2005). Shqipja standarde - si ta flasim dhe ta shkruajmë, 'Toena', Tiranë.
32. Miller, B. (2003). Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit, QPEA, Ferizaj.
33. Miller, B. (2004). Unë mund të mësoj, QPEA, Ferizaj.
34. Murati, Q. (2009). Për shqipen standarde, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
35. NCEE (2012). Teaching Elementary School Students to Be Effective Writers, U.S. Department of Education, Institute of Education Sciences
36. Ogano, J. (2012). Teaching Learners with reading and writing problems in the Classroom, University of Oslo.
37. Räsänen, P. & Tahiraj, G., (2008). Test leximi për Kosovë, FSDEK II, Prishtinë.
38. Rayner, K., Foorman, B.R., Perfetti, Ch.A., Pesetsky, D., & Seidenberg, M., S., (2001). How Psychological science informs the teaching of reading, American Psychological Society, vol.2, no.2.
39. Rayner, K., et al., (2001). *"How psychological science informs the teaching of reading"* (PDF). Psychological Science in the Public Interest. 2. 2: 31–74.

40. Sanabria Díaz G, Torres Mdel R, Iglesias J, et al. (2009). Changes in reading strategies in school-age children, *Span J Psychol.* 12 (2): 441–53.
41. Sparapani, N., Conor C., McLean L., Wood T., Toste J., Day S., (2018). Direct and Reciprocal Effects among Social Skills, Vocabulary, and Reading Comprehension in First Grade, *Contemporary Educational Psychology*.
42. Sebastian Suggate, (2012). "Watering the garden before a rainstorm: the case of early reading instruction" in *Contemporary Debates in Childhood Education and Development*, ed. Sebastian Suggate, Elaine Reese. pp. 181–190.
43. Snow, Catherine S., Burns, M., Susan, Ed., Grigtin, P., (1998). *Preventing Reading Difficulties in Young Children*, Washington, DC, National Academy Press.
44. Stahl, S., & Nagy, W. (2005). Teaching word meaning. Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum. Traweek, D. (1993). Teacher and learner variables in early literacy instruction: Treatment, evaluation and ethnographic studies. Unpublished doctoral dissertation, University of Washington, Seattle, WA.
45. Stanovich, K. E. (1986). Matthew effects in reading: Some consequences of individual differences in the acquisition of literacy. *Reading Research Quarterly*, 21(4), 360–407. <https://doi.org/10.1598/RRQ.21.4.1>
46. Treiman, R. (2018). What research tells us about reading instruction. *Psychological Science in the Public Interest*, 19(1), 1–4.
47. USAID (2016). Studim për vlerësimin e shkrim-leximit fillestar në fushë të gjuhës dhe njohurive themelore matematikore në klasat fillestare në Maqedoni, raport për projektin “Leximi ju bën udhëheqës”.

48. Wray, D. & Lewis, M. Children reading and writing non-fiction, (2005). Taylor & Francis e-Library, London.
49. Zabeli, N. (2004). Vështirësitë në të nxënë, Handikos, Prishtinë.

Artikuj/raporte on-line:

- <http://www.readingrockets.org/article/prevention-and-intervention-writing-difficulties-students-learning-disabilities>,
- <https://kids-first.com.au/5-ways-to-identify-reading-problems-in-children/>,
- <http://www.readandspell.com/us/common-reading-problems>,
- <http://lesesenteret.uis.no/reading-and-writing-problems/>,
- <http://lesesenteret.uis.no/reading-and-writing-problems/dyslexia/extra-problems-with-reading-difficulties-article91012-12638.html>,
- <http://lesesenteret.uis.no/reading-and-writing-problems/dyslexia/challenging-dyslexia-research-article80189-12638.html>,
- <http://lesesenteret.uis.no/category.php?categoryID=14037>,
- <http://lesesenteret.uis.no/reading-and-writing-problems/prevention/challenges-article79953-12643.html>,
- <http://lesesenteret.uis.no/reading-and-writing-problems/prevention/belief-in-own-abilities-produces-results-article79937-12643.html>,
- <http://lesesenteret.uis.no/reading-and-writing-problems/prevention/belief-in-own-abilities-produces-results-article79937-12643.html>,
- <https://kids-first.com.au/5-ways-to-identify-reading-problems-in-children/>.

- <https://www.readingrockets.org/article/learning-read-and-write-what-research-reveals>, shkarkuar më 14.02.2019
- <http://www.readingrockets.org/article/knowledge-and-skills-teaching-reading>
- https://www.researchgate.net/publication/296198485_Ngritja_e_shkathtesise_se_leximit_permes_ushtrimeve_te_nxenesit_e_klasave_te_hershme,
- www.kec-ks.org/wp-content/.../BEP-Doracaku-i-leximit-Final.pdf,
- www.prvite5.mk www.facebook.com/prvite,
- www.fjalorshqip.com

Botues
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi
Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 650 copë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37: 811

37:821

Bytyqi - Beqiri, Liirije

Vështirësitë e nxënësve të arsimit fillor në shkrim-
lexim / Liirije Bytyqi – Beqiri. - Prishtinë :
Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2019. – 102 f. :
ilustr. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-591-49-2

ISBN 978-9951-591-49-2



9 789951 591492